

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7159
E shtunë, 6 prill 2024
Çmimi 0.50

Dështimet në dialog të Kurtit dhe pasojat për Kosovën

Shkruan:
Avdullah HOTI



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FILLON REGJISTRIMI I POPULLSISË, KUSH E BOJKOTON GJOBITET NGA 20 EURO DERI NË 2 000 EURO

- Kurti u bënë thirrje për bashkëpunim komunave dhe ASK-së për regjistrimin e popullsisë



Të premten ka nisur regjistrimi i popullsisë në Kosovë. Këtë herë ky proces do të zhvillohet me disa ndryshime. Ai do të zhvillohet edhe në komunat me shumicë

serbe në veri të Kosovës dhe do të ketë edhe formularë shtesë për dëmet e luftës. Kushdo që e bojkoton procesin rrezikon të gjobitet nga 20 euro deri në 2 000

euro. Kryeministri Albin Kurti në takim me kryetarët e komunave ka bërë thirrje për bashkëpunim mes qeverisë, komunave dhe ASK-së për regjistrimin e popullsisë

25 VJET NGA MASAKRA E REZALLËS, FORCA TË REGJIMIT GJENOCIDAL TË SERBISË NË MËNYRË MIZORE VRANË 98 DJEM DHE BURRA



KAMBERI DHE LUTFIU TAKOJNË LAJÇAKUN, DISKUTOJNË PËR SFIDAT ME TË CILAT BALLAFAQOHEN SHQIPTARËT E LUGINËS



NGA 1 QERSHORI QYTETARËT DO TË KOMPENSOHEN PËR RRYMËN NË VERI

LDK-JA: RRRITJA E ÇMIMEVE TË PRODUKTËT BAZË GJATË TRE VITËVE TË FUNDIT KA SHKUAR DERI NË 42 %

SPORT



SOT DY NDESHJE, NESËR DERBI LLAPI - DRITA

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja s'komenton paralajmërimet e Serbisë për ta penguar Kosovën drejt Këshillit të Evropës

PRISHTINË, 5 PRILL - Bashkimi Evropian tha se nuk dëshiron t'i komentojë paralajmërimet e Serbisë se do të punojë për ta parandaluar anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Nga blloku evropian vetëm përsëritën thirrjet ndaj të dyja palëve që të zbatojnë me urgjencë Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve një vit më parë.

Kosova është në pritje të vendimit për pranimin eventual në Këshillin e Evropës dhe gjasat për anëtarësim janë rritur pas dhënies së mendimit pozitiv nga Komiteti për Politikë dhe Demokraci i kësaj organizate.

Por, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, i ka bërë thirrje qeverisë serbe të formojë një grup të veçantë për të punuar për parandalimin e anëtarësimin në Këshillin e Evropës.

Neni 4 i Marrëveshjes në rrugën drejt normalizimit, që Kosova dhe Serbia arritën në shkurt të vitit 2023, thotë se "Serbia nuk do ta

kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare".

Në pyetjen se a është Serbia duke e shkelur këtë marrëveshje, arrijen e së cilës e ka lehtësuar BE-ja, duke kundërshtuar pranimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, dha një përgjigje të përgjithshme. "Nuk dua të hyjë në komente të asaj se çfarë është thënë se çfarë dëshiron të bëjë presidenti Vučić. Unë mund të përsëris se, bazuar në pritjet e Bashkimit Evropian, si Serbia ashtu edhe Kosova duhet pa vonesa të tjera të nisin të zbatojnë marrëveshjen për të cilën ishin pajtuar para më shumë se një viti në Ohër. Kjo është me rëndësi të madhe. Kur bëhet fjalë për Këshillin e Evropës, çështjet e anëtarësimin i takojnë Këshillit të Evropës", tha Stano.

Ai përsëriti thirrjet e BE-së për Kosovën dhe Serbinë që të fokusohen në zbatimin e marrëveshjes si çështje urgjente



dhe se kjo, sipas këtij zëdhënësi, po u komunikohet palëve nga ana e bllokut. "Nëse ata dëshirojnë, apo nëse vazhdojnë të dëshirojnë në zbatimin e asaj për çfarë janë pajtuar, kjo do të ketë pasoja serioze. Këto pasoja janë të lidhura me integrimin e tyre në BE", tha Stano.

Në pyetjet e përsëritura se pse BE-ja nuk deklarohet nëse Serbia, me veprimet e saj kundër anëtarësimin të Kosovës në Këshillin e Evropës, po e shkel

marrëveshjen, Stano përsëriti se "Këshilli i Evropës është një organizatë e ndryshme nga BE-ja". Edhe në pyetjen se a e marrin seriozisht kërcënimin e Serbisë se do të largohet nga Këshilli i Evropës në rast se Kosova bëhet anëtare, ky zëdhënësi i BE-së ka përsëritur se nuk i takon BE-së të komentojë për këtë çështje. "Këshilli i Evropës është një organizatë krejtësisht e ndryshme nga Bashkimi Evropian. Pra, kjo nuk duhet të ngatërrohet. Nëse

një vend vendosë të nisë diskutimet për t'u larguar nga anëtarësia në Këshillin e Evropës apo të modifikojë anëtarësinë, kjo vërtetë nuk është diçka që i takon Bashkimit Evropian të komentojë", u shpreh Stano. Ai shtoi se, megjithatë, Këshilli i Evropës është një organizatë shumë e rëndësishme për demokraci dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Kosova synon të anëtarësohet në Këshillin e Evropës në muajt në vijim, pasi javën e kaluar, Komiteti për Politikë dhe Demokraci i kësaj organizate e miratoi raportin e raportueses për Kosovën, Dora Bakoyannis, i cili rekomandoi se ajo i ka plotësuar kushtet për t'u bërë anëtare e plotë e Këshillit të Evropës.

Asambleja Parlamentare pritet të votojë për anëtarësimin e Kosovës në prill, dhe nëse ajo jep dritën jeshile, atëherë fjalën përfundimtare duhet ta japë Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës në maj.

Dodiku e dekoron Orbanin me çmim shtetëror

BANJA LLUKË, 5 PRILL - Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, u dekorua të premten me çmim shtetëror nga Millorad Dodik, lideri i Republikës Sërpska që është i sanksionuar nga Perëndimi, gjatë vizitës së tij kontroverze në Bosnjë-Hercegovinë.

Dodik ia dorëzoi Orbanit çmimin "Urdhri i Republikës Sërpska" në një ceremoni në Banja Llukë. Takimi i Orbanit është vëzhguar nga afër prej zyrtarëve të Bashkimit Evropian, presidencën e së cilës do ta udhëheqë Orban nga korriku.

Dodik, një nacionalit i cili ia dha çmimin e njëjtë edhe presidentit rus Vladimir Putin vitin e kaluar, është i sanksionuar nga Shtetet e



Bashkuara dhe Britania e Madhe për shkak të përpjekjeve të tij për ta minuar marrëveshjen për paqe

Dejton, e cila i dha fund luftës së Bosnjës në vitet '90. Duke e shpjeguar dekoratën për

Orbanin, Dodik tha se ky çmim u jepet "miqve të mëdhenj dhe të vërtetë", dhe se Orbanin u shpërblye me të për kontributin e tij në bashkëpunimin e mirë midis Republikës Sërpska dhe Hungarisë. "Serbët dhe hungarezët duhet të bashkëpunojnë në nivelin më të lartë të mundshëm dhe kjo nuk drejtohet kurrë kundër një pale të tretë", tha Dodik.

Orban paralajmëroi "vizita më të shpeshta" në Bosnjë e Hercegovinë, pasi Hungaria e merr presidencën e Bashkimit Evropian, në fillim të korrikut. "Unë gjithmonë i kam mbështetur serbët në politikën ndërkombëtare, sepse kam fituar

bindjen se politika ndërkombëtare është e padrejtë, nuk është një politikë e drejtë. Në Evropë nuk e pranojnë se Evropa ka nevojë për serbët. Pa serbët nuk ka siguri evropiane", tha Orban.

Ai theksoi se e ka një ekip "të veçantë që do të merret me Ballkanin Perëndimor, madje një ekip brenda tij që do të merret me Bosnjë e Hercegovinë".

Lideri populist hungarez është njëri prej aleatëve kryesorë të Dodikut dhe njëri prej politikanëve të pakët të NATO-s dhe BE-së që ka vullnet të takohet me të.

Hungaria ia ka premtuar Republikës Sërpska 100 milionë euro ndihmë.

Ministrja finlandeze: S'është koha të bisedohet për ligjin për armët



HELSINKI, 5 PRILL - Finlanda e ka tashmë një ligj goxha "të rehtë" për armët dhe nuk është tani koha e duhur për të biseduar për ashpërsimin e tij, tha të premten ministrja e Brendshme e Finlandës, Mari Rantanen. Ajo e tha këtë disa ditë pas një sulmi me armë në një shkollë fillore në afërsi të kryeqytetit Helsinki.

Të martën, një djalë 12-vjeçar e qëllloi me armë për vdekje një nxënës moshatar të klasës së gjashtë dhe i plagosi rëndë dy nxënës, përfshirë një vajzë nga Kosova.

Të enjten policia finlandeze tha se

një nga vajzat e plagosura ka nënshitetësi të dyfishtë, kosovare dhe finlandeze. Ajo tha se të dyja vajzat e plagosur rëndë janë duke u mjekuar ende në spital.

Policia tha se 12-vjeçari, i cili është arrestuar, e mori me vete revolen e një të afërmi në shkollën fillore "Viirtola" në afërsi të Helsinkit dhe i qëllloi tre nxënës dhe i kërcënoi disa të tjerë. Sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme të Finlandës, në vend janë lëshuar më shumë se 1.5 milion licenca të armëve të zjarrit. Rreth 430.000 persona janë të licencuar për armëmbajtje në

Finlandën.

Finlanda është në mesin e vendeve të Bashkimit Evropian me shkallën më të lartë të civilëve që mbajnë armë zjarri për kokë banori, sipas një studimi të vitit 2018, por Rantanen tha se numri i lartë i armëve nuk e bën Finlandën "vend të dhunshëm". "Hetimi policor është në fazë fillestare dhe, edhe nëse ata bëjnë përparim të shpejtë, kjo në asnjë mënyrë nuk nënkupton se tani është koha e duhur për të komentuar nëse ne duhet ta ashpërojmë ligjin tonë për armët", tha Rantanen për Reuters.

25 vjet nga masakra e Rezallës, forca të regjimit gjenocidal të Serbisë në mënyrë mizore vranë 98 djem dhe burra



Më 5 prill të vitit 1999 policia dhe ushtria okupatore serbe masakruan 98 shqiptarë në Rrezallë të Skenderajt dhe në fshatrat përreth, ndërsa trupat e 44 prej tyre ata i zhdukën me dhunë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 PRILL - Presidentja Vjosa Osmani ka kujtuar 25-vjetorin e masakrës së Rezallës, me ç'rast ka theksuar se forca të regjimit gjenocidal të Serbisë, më 5 prill të vitit 1999, rrethuan shtëpitë e fshatit Rezallë dhe në mënyrë mizore vranë 98 djem e burra.

"Eshtrat e 44 të varrëve janë gjetur disa vjet më pas në Rudnicë të Rashkës. Regjimi kriminal serb kreu krime të tilla makabër kudo nëpër Kosovë, ndaj sjellja para drejtësisë e autorëve të krimit është e nevojshme dhe e domosdoshme. Drejtësi për viktimat dhe kujtim i përhershëm për to! Qoftë i përhershëm kujtimi për të gjithë të rënë për liri!", ka

thënë Osmani në deklaratën për medie.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se Rrezalla nuk ishte episod i izoluar apo rast përjashtimor, por ndodhi në vazhden e fushatës së krimeve kundër njerëzimit, gjenocidit, masakrave të njëpasnjëshme dhe spastrimit etnik, që ishin mekanizma dhe mjete të shtetit të Serbisë, si strukturë e kalkulimit dhe gjenocidit të vrasjes në masë. "Serbisë i kanë ndryshuar rrethanat, por jo mendësia. Pa e ndryshuar mendësinë dhe pa u përballur me krimet e veta, përballë nesh ajo do të përbëjë gjithnjë shtetin e zhytur në krimin e përbindshëm dhe kërcënim të vazhdueshëm. Ne kemi dëshmorë e martirë të cilëve u përkulemi, ndërsa Serbia kriminelë lufte që i

mburon. Rrezalla është pjesë e dhimbjes sonë të madhe, ku martirët lanë dëshminë e sakrificës si çmim të lirisë. Për ta ne do të vijojmë të kërkojmë drejtësi. Sot bëra homazhe aty, për nder të kësaj sakrifice të tyre. Ata nuk do të harrohen kurrë, sepse gjithmonë do të frymojnë tek liria jonë, e do të kujtohen përherë, sepse qëndrojnë në themelet e shtetit tonë", ka shkruar Konjufca në "Facebook".

Edhe kryeministri Albin Kurti ka përkujtuar martirët e Rezallës së Skenderajt, 98 burra dhe djem u pushkatuan vetëm për shkak se ishin shqiptarë. Të shtënat kishin zgjatuar 30 minuta. Pas ekzekutimit mizor e barbarë më 5 prill 1999, forcat e armatosura të Serbisë ua rrëmbyen kufomat. 29 prej tyre janë gjetur në varrezën masive në Rudnicë të Rashkës, në Serbi. Nga Kizhevaku i Serbisë, më 30 shtator 2021, na u kthyen në Kosovë eshtrat e shtatë prej të varrëve në këtë masakër. Mes tyre ishin edhe dy ribashkime me eshtrat e zhvarrosura vite më parë nga

varreza masive në Rudnicë të Serbisë. Andaj, sot e gjithnjë u bëj thirrje partnerëve ndërkombëtarë që nga Serbia, si përgjegjëse për vrasjen dhe zhdukjen e të dashurve tonë, të kërkojnë zbardhjen e plotë të fatit të tyre dhe drejtësi për viktimat dhe familjet. Drejtësia vendore duhet pa vonesë dhe me ngulm të veprojnë, që përgjegjësit, urdhërdhënësit dhe ekzekutorët, të gjykojnë e të dënojnë", ka thënë Kurti.

Ai ka theksuar se e vërteta e krimeve të Serbisë në Kosovë nuk mund të mbulohej nga dheu i varrezave masive. "Nuk mund të lejojmë harresën të mbulojë mizoritë që ndodhën në luftë. Duke nderuar të kaluarën, me drejtësi për viktimat, angazhohemi për të ardhmen e Republikës sonë. Për Kosovën e pavarur, ku brezat e rinj rriten të lirë e të sigurt. Duke mësuar nga e kaluara, ecim përpara me shpresë dhe vendosmëri. Përkujtimi ynë është dëshmi e përkushtimit për të mos harruar sakrificat për të shtrenjtën e shenjtën liri. I

përrjetshëm qoftë kujtimi i martirëve të kombit nga Rrezalla!", ka deklaruar kryeministri Kurti. Këtë masakër e ka kujtuar edhe lideri i PDK-së, Memli Krasniqi. "Burim Zabeli, 13 vjeç, po refuzonte t'i ndahej babait të tij, Xhemajlit, i cili kishte probleme me shikim. Dhe ashtu, dorë për dorë, pranë një lisi, kriminelët serbë i pushkatuan të dy. Trupat e Burimit dhe Xhemajlit u gjetën vetëm disa vite pas vrasjes në një varr masiv në Serbi - pasi aparati kriminal shtetëror, në mënyrë të orkestruar, kishte provuar t'i zhdukë trupat. 98 civilë shqiptarë, të të gjitha moshave, u vranë mizorisht në Rezallë më 5 prill të vitit 1999. Nuk u kursye askush. As fëmijët dhe as të moshuarit. Edhe për këtë masakër, sikur për shumë të tjera që ka kryer regjimi gjenocidal serb, ende s'kanë dalë para drejtësisë urdhërdhënësit dhe ekzekutorët. Lavdi e përrjetshme dëshmorëve dhe martirëve të vendit tonë, mbi sakrificën e të cilëve qëndron liria dhe pavarësia e Kosovës!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Edita Tahiri: Asociacioni nuk është kusht për anëtarësimin e Kosovës në KE, kusht duhet të jetë njohja de jure

PRISHTINË, 5 PRILL - Edita Tahiri, ish-kryenegociatore e Kosovës në dialogun me Serbinë, ka theksuar se Asociacioni i Komunave me

Shumicë Serbe nuk është kusht për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës por, sipas saj, kusht duhet të jetë njohja de jure e

shtetit të Kosovës. "Asociacioni nuk është kusht për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, kusht duhet të jetë njohja de jure e

shtetit të Kosovës nga Serbia. Këtë propagandë që po e bën Kurti është për t'u hedhur hi syve militantëve të VV-së", ka shkruar Tahiri në "Facebook".





Fillon regjistrimi i popullsisë, kush e bojkoton gjobitet nga 20 euro deri në 2 000 euro

- Kurti u bënë thirrje për bashkëpunim komunave dhe ASK-së për regjistrimin e popullsisë

Të premten ka nisur regjistrimi i popullsisë në Kosovë. Këtë herë ky proces do të zhvillohet me disa ndryshime. Ai do të zhvillohet edhe në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës dhe do të ketë edhe formularë shtesë për dëmet e luftës. Kushdo që e bojkoton procesin rrezikon të gjobitet nga 20 euro deri në 2 000 euro.

Kryeministri Albin Kurti në takim me kryetarët e komunave ka bërë thirrje për bashkëpunim mes qeverisë, komunave dhe ASK-së për regjistrimin e popullsisë

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 5 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u ka bërë thirrje kryetarëve të komunave të Kosovës dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) të bashkëpunojnë për procesin e regjistrimit të popullsisë i cili filloi të premten dhe pritet të zgjasë deri më 17 maj.

Gjatë një takimi me kryetarët e komunave në Prishtinë, Kurti tha se "angazhimi ynë i përbashkët është i domosdoshëm për t'i adresuar nevojat e qytetarëve pa dallim dhe është baza për vendime të cilat do të ndikojnë në të ardhmen e Kosovës". "Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe i banesave në Republikën e Kosovës ka filluar sot. Të dhënat mbi madhësinë, shpërndarjen dhe përbërjen e popullsisë, kushtet e jetesës e nivelin e edukimit, do të na ndihmojnë në orientimin e politikave dhe shërbimeve më të mira për qytetarët, neve si qeveri, juve si komuna dhe çdo institucioni të

Republikës sonë. Po e mbështesim Agjencinë e Statistikave të Kosovës që është, njëherësh, bartëse e projektit të regjistrimit, me qëllim që regjistrimi të jetë cilësor, profesional dhe gjithëpërfshirës. Por në mënyrë që të jetë i plotë suksesi i këtij procesi, me rëndësi qenësore për zhvillimin socio-ekonomik të vendit tonë, nevojitet bashkëpunim i ngushtë edhe ndërmjet Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe komunave të Republikës. Andaj, sërish bëj thirrje për përkushtim dhe angazhim të përbashkët në një ndërmarrje tejet të rëndësishme institucionale të vendit tonë. Angazhimi ynë i përbashkët është i domosdoshëm për të adresuar nevojat e qytetarëve pa dallim dhe është baza për vendime të cilat do të ndikojnë në të ardhmen e Kosovës. Cilësia e të dhënave nga pyetësorët është vendimtare për cilësinë e qeverisjes, si qendrore ashtu edhe lokale, për planifikim e zbatim më të drejtë, e suksese e arritje edhe më të mëdha", ka thënë Kurti.

Regjistrimi i popullsisë,

ekonomive familjare dhe banesave do të përfshijë edhe një pyetësor, cili do t'u mundësojë qytetarëve të deklarohen edhe për dëmet që u ka shkaktuar lufta gjatë viteve 1998/1999. "Në këtë regjistrim të popullsisë, për herë të parë, është përfshirë pyetësori i dëmeve nga lufta 1998/1999, në ekonominë familjare të popullit tonë. Qytetarët do të mund t'i deklarojnë dëmet ekonomike, shumat e pronave të shkatërruara, si dhe dëmet në njerëz, familjarë të vvarë, të zhdukur, të plagosur apo të burgosur. Më saktësisht kjo periudhë përkufizohet: prej 28 shkurtit 1998 deri më 12 qershor 1999. Kjo na ndërlidhë me pikën e dytë të rendit të ditës së sotme, Institutin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë, të cilin e kemi funksionalizuar për të dokumentuar me saktësi të gjitha krimet, anembanë Kosovës. Është thelbësore që të bashkojmë forcat, sepse qëllimin e kemi të përbashkët.

Për institucionalizimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kujtesës kolektive, e cila nuk do të na shërbejë vetëm neve, por edhe brezave që do të vijnë pas nesh. Andaj, në frymë të bashkëpunimit, ju ftoj që të angazhohemi bashkë për të kontribuar në këto dy procese kaq të rëndësishme për Republikën tonë, për historinë tonë dhe për të ardhmen tonë", ka thënë Kurti. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, tha se regjistrimi i popullsisë do të bëhet duke respektuar parimet e mbrojtës së të dhënave dhe të drejtat e privatësisë. "Ky proces

nuk është vetëm një procedurë burokratike. Është gur themel i qeverisjes moderne dhe zhvillimit shoqëror. Duke regjistruar me saktësi informacionin demografik, ne do të kuptojmë dhe do t'u shërbejmë më mirë qytetarëve tanë", ka theksuar Krasniqi, duke shtuar se regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është padyshim jetik për funksionimin e shoqërive në mbarë botën dhe siguron që çdo individ të llogaritet brenda një shoqërie. "Me kryetarët e komunave ndamë bindjen e përbashkët se regjistrimi i popullsisë është thelbësor për qeverisjen efektive, shpërndarjen e burimeve dhe politikëbërjen. Roli i rëndësishëm i komunave në këtë proces dhe të dhënat që do të sigurojmë do të ndikojnë edhe në caktimin e shumës së grantit qeveritar për atë komunë për të adresuar nevojat e qytetarëve të tyre", ka deklaruar Krasniqi. Ai në fund të takimit i ka falënderuar kryetarët e komunave për përgatitjet dhe bashkërendimin institucional që së bashku të sigurojnë që regjistrimi i popullsisë të kryhet me përpikëri dhe me përgjegjësi për të mirën e përgjithshme, të jetë gjithëpërfshirës dhe t'i shërbejë drejtësisë sociale dhe të ardhmes kolektive.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Avni Kastrati, ka thënë se regjistrimi është obligim. "Qytetarët që nuk marrin pjesë do të dënohen nga

20 deri në 2 000 euro", ka thënë ai. Ky do të jetë regjistrimi i parë i popullsisë prej vitit 2011 dhe për herë të parë do ta përfshijë edhe komunitetin serb në veri të Kosovës. Megjithatë, Lista Serbe ka thënë të premten se serbët e Kosovës nuk do të marrin pjesë në regjistrimin e popullsisë në Kosovë.

Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve të Kosovës që e gëzon edhe mbështetjen e Beogradit zyrtar - e akuzoi kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, për "shtypjen shumëvjeçare të serbëve" në Kosovë.

Gjatë regjistrimit të fundit të popullsisë në Kosovë, të mbajtur në vitin 2011, procesi nuk ishte zhvilluar në katër komunat me shumicë serbe në veri dhe ishte bojkotuar pjesërisht edhe në komunat e tjera me shumicë serbe në Kosovë.

Bojkoti kishte ndodhur pasi autoritetet nga Beogradi i kishin kërkuar banorëve serbë në Kosovë të marrin pjesë vetëm nëse regjistrimi bëhet nga misioni i OKB-së në Kosovë, UNMIK. Sipas regjistrimit më 2011, numri i përgjithshëm i banorëve në Kosovë është rreth 1.8 milion, prej të cilëve rreth 25 000 janë serbë. Megjithatë, sipas vlerësimeve të sektorit civil, rreth 100 000 pjesëtarë të komunitetit serb jetojnë në Kosovë.

Regjistrimi i ri i popullsisë ishte menduar të mbahej në vitin 2021, por ai u shty për shkak të pandemisë së virusit korona. Ndërkohë vitin e kaluar është shtyrë edhe dy herë të tjera.

Ramadani kërkon nga liderët e shtetit ta sqarojnë qëndrimin shtetëror për Asociacionin

PRISHTINË, 5 PRILL - Ish-kryeinspektori i Agjencisë Kosovare për Inteligjencë (AKI), Burim Ramadani, ka kërkuar nga liderët shtetërorë t'i sqarojnë qëndrimet e tyre për draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ramadani në rrjetin social në "Facebook" ka shkruar se Qeveria e Kosovës po i bën dëm Kosovës duke mos publikuar draft-statusin e Asociacionit. "Nuk ka asgjë më të papranueshme sesa

mungesa e transparencës në proceset që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe. Kështu u dëmtua rëndë përmbajtja. Paramendojeni sikur një leadership transparent të kishte publikuar vet Draft-Statutin për Asociacionin. Sa mirë do të bënte. Sa shumë do të ndihmonte pozicionin e Kosovës. Ta debatoni atë në detaje me: profesorët universitarë, ekspertët Kushtetues, ekspertët e qeverisjes lokale, studiuesit e politikave të akomodimit

(integritet), partitë politike (madje përfshirë edhe partinë në pushtet - sepse edhe aty veç një grup fort i ngushtë i njerëzve është i informuar me përmbajtjen e proceseve, të tjerët janë kasetofonë propagandues injorantë!), shoqërinë civile, mediat. Pse jo, edhe me ekspertë të njohur ndërkombëtarë e rajonalë", ka shkruar Ramadani. Ai, po ashtu, pyeti se pse tre liderët e shtetit nuk dalin bashkë dhe ta njoftojnë opinionin publik.



Sesioni pranveror i Asamblesë Parlamentare të KiE-së, Kosova pikë kryesore e rendit të ditës



PRISHTINË, 5 PRILL - Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës i ka bërë me dije disa nga pikat e agjendës së sesionit pranveror, ndërkaq këtyre pikave i prin çështja e anëtarësimit të Kosovës në KiE.

Në një njoftim të Asamblesë Parlamentare thuhet se debati mbi aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës

dhe votimi i një draft-opinionit do të jetë një moment kryesor i sesionit pranveror. "Sesioni pranveror po vjen...! Një debat mbi aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe votimi i një draft-opinionit, do të jetë një moment kryesor i sesionit pranveror të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE), që do të mbahet

në Strasburg nga 15 -19 prill 2024", thuhet në njoftimin për medie.

Pikët tjetër e rendit të sesionit pranveror do të jetë debati, siç thuhet, për "vdekjen e Alexei Navalny dhe nevojën për t'iu kundërvënë regjimit totalitar të Vladimir Putin dhe luftës së tij kundër demokracisë".

Lidhur me procesin e

anëtarësimit të Kosovës në KiE një ditë më parë ka folur edhe presidentja Vjosa Osmani. Në një takim me të dërguarin e posaçëm të Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Lordin Stuart Peach, Osmani ka thënë se anëtarësimi i Kosovës do të ishte triumf për demokracinë dhe për të drejtat e njeriut jo vetëm në Kosovë, por në mbarë Evropën.

"Anëtarësimi i Kosovës do të ishte triumf për demokracinë dhe për të drejtat e njeriut jo vetëm në Kosovë, por në mbarë Evropën", citohet të ketë thënë presidentja. Më tutje, Osmani ritheksoi se përmes mekanizmave të ndryshëm që i ofron Këshilli do të mundësohej mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim.

FSK-ja përfundon me sukses trajnimin me mortaja të udhëhequr nga instruktorët turq

PRISHTINË, 5 PRILL - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka njoftuar se pjesëtarët e FSK-së në Regjimentin e Tretë të Këmbësisë kanë përfunduar me sukses trajnimin me Mortaja 81 mm, të udhëhequr nga instruktorët e KFOR-it turk. "Pjesëtarët e FSK-së në Regjimentin e Tretë të Këmbësisë (R3K) kanë

përfunduar me sukses trajnimin me Mortaja 81mm, të udhëhequr nga instruktorët e kontingjentit turk" ka njoftuar Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci. Trajnimi i realizuar kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve ushtarake në nivel të regjimentit dhe rritjen e ndërveprueshmërisë me partnerët në fushën e

mbështetjes me zjarr për këmbësori të lehtë. "Në ceremoninë përmbyllëse komandanti i kontingjentit turk, kolonel Sabri Gokhan Karamursel, u nda i kënaqur me bashkëpunimin dhe mundësinë për të ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve operacionale të FSK-së", thuhet në njoftimin e Maqedonci.



Shpërndahet mekanizëm bujqësor për fermerët në Gjilan në vlerë mbi 10 mijë euro

GJILAN, 5 PRILL - Drejtorja për Bujqësi dhe Pylltari ka vazhduar shpërndarjen e mekanizmit bujqësor për fermerët e komunës së

Gjilanit. Drejtori Bajram Isufi tha se përfitues të mekanizmit bujqësor në vlerë prej 10 mijë e 780 eurosh janë

dymbëdhjetë përfitues. Sipas tij, janë shpërndarë 4 copë rotofreza, 2 copë pijatore me 20 disqe, 5 copë pijatore me 24 disqe dhe 1 copë pllugj dy

brazësh 25 cm. Drejtori për Bujqësi dhe Pylltari tregoi se ky është vazhdim i shpërndarjes së projektit të herës së kaluar.



Kamerat e sigurisë vendosen në vilën e konfiskuar të Radoiqiqit, Haxhiu dhe Sveçla e vizitojnë afër

PRISHTINË, 5 PRILL - Ministrija e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, bashkë me ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, kanë shkuar për vizitë në veri të vendit, konkretisht te vila e terroristit Milan Radoiqiq. Haxhiu ka thënë se ishin për vizitë te kjo vilë për të parë në qoftë se të gjitha veprimet që është dashur të merren nga Ministria e Drejtësisë janë adresuar, e sidomos në kuptimin e sigurisë, teksa ka bërë me dije se aty janë vendosur edhe kamera të sigurisë. "Tashmë kjo vilë ka të vendosura kamerat e sigurisë,

për ta përcjellë secilin detaj e secilën lëvizje dhe për të parandaluar çfarëdo përpjekje për ta penguar punën e zyrtarëve, por edhe të policisë. Mirëpo, përveç kamerave, është edhe policia që po qëndron këtu për ta ruajtur këtë pasuri të paluajtshme", ka thënë Haxhiu. Policia e Kosovës të enjten i ka konfiskuar disa prona të terroristit Milan Radoiqiq, në mesin e tyre janë shumë vetura, banesa, restorant dhe anije, të cilat tashmë janë nën menaxhimin e Ministrisë së Drejtësisë.



2 700 nxënës të arsimit parauniversitar përfitojnë nga programi "Arti në Shkolla"

PRISHTINË, 5 PRILL - Për rreth dy muaj 2 700 nxënës të arsimit parauniversitar nga 60 shkolla në nivel vendi kanë ndërvepruar aktivisht me artin duke përfituar aftësi në aktivitete të ndryshme kulturore në kuadër të programit "Arti në Shkolla". Përgjatë vetëm pjesës së parë të fazës së tretë të pilotimit, të njëjtit nxënës kanë marrë pjesë në 35 aktivitete kulturore, përmes orëve të veçanta të artit me artistë në klasa shkollore,

vizita direkte në institucionet kulturore dhe në monumente të trashëgimisë kulturore dhe me pjesëmarrjen e tyre në shfaqje të ndryshme artistike, nxënësit kanë pasur mundësi të shprehin talentin e tyre në lexim, teatër, muzikë dhe trashëgimi kulturore. "Arti në Shkolla" është program i Ministrisë së Kulturës, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe institucionet e tjera partnere të

kulturës në nivel qendror dhe lokal. Kontribut në realizmin e këtij programi janë duke dhënë edhe organizatat joqeveritare kulturore, ndër to, Dokufest, Fondacioni 17, Autostrada Biennale, Yunus Emre Institute, Ec Ma Ndryshe, MUSE Kosova, Ballkan Arena dhe artistët individualë Luljeta Goranci, Fatos Kabashi, Agon Rexhepi, Valmira Mehmeti, Anda Gjini e të tjerë.

AGK-ja pranon donacion 70 xhaketa dhe jelekë me mbishkrimin "Press" nga misioni i OSBE-së në Kosovë

PRISHTINË, 5 PRILL - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës i ka pranuar donacion 70 xhaketa dhe jelekë me mbishkrimin "Press" nga partneri i ngushtë i saj, Misioni i OSBE-së në Kosovë. Siç thuhet në njoftimin e bërë nga AGK-ja, donacionet u dhanë nga

drejtoresha e Departamentit të Demokratizimit, Pascale Roussy. "Donacionet u ndanë nga drejtoresha e Departamentit të Demokratizimit, Pascale Roussy - e cila theksoi rolin crucial që gazetarët dhe kameramanët e kanë në

demokraci, duke raportuar nga terrene të rrezikshme e duke i mbajtur përgjegjës personat në pushtet", thuhet në njoftimin e AGK-së. Shpërndarja e këtyre donacioneve te gazetarët do të bëhet gjatë javëve në vijim nga AGK-ja.



Munguan ministrat, shtyhet seanca e pyetjeve parlamentare

PRISHTINË, 5 PRILL - Kuvendi i Republikës së Kosovës, kryesuar nga nënkryetarja Saranda Bogujevci, mbajti të premtën seancë të rregullt plenare, me të

vetmen pikë të rendit të ditës: pyetje parlamentare. Përgjigje në pyetjet e deputetëve dhanë ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku dhe ministri i

Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, kurse në mungesë të ministrave të tjerë, deputetët e pranishëm pyetjet i bartën

për në një nga seancat e radhës. Pas përfundimit të pyetjeve parlamentare, nënkryetarja Bogujevci mbylli punimet e kësaj seance.



Dështimet në dialog të Kurtit dhe pasojat për Kosovën



Shkruan: Avdullah HOTI

Po flitet se, krahasuar me ndërmjetësit e mëparshëm, Borell dhe Lajçak nuk arritën asgjë në dialog gjatë mandatit të tyre që mbaron në maj. Por, për fatin e keq të Kosovës, e vërteta është krejtësisht ndryshe:

1. Baronsha Ashton arriti marrëveshjen e vitit 2013, ku

parashihej një asociacion me kompetenca deri në vijën e atyre ekzekutive, e cila u ratifikua në Kuvendin e Kosovës dhe mundësoi, me gjithë vështirësitë në zbatim, shtrirjen e institucioneve të shtetit të Kosovës në veri;

2. Zonja Mogerini arriti marrëveshjen e vitit 2015 për parimet e themelimit të asociacionit, por kryeministri Mustafa u siguroi që kompetencat e asociacionit të jenë në përputhje me Kushtetutën, duke marrë miratimin e Gjykatës Kushtetuese para se statuti i asociacionit të fuqizohej;

3. Ndërsa, Borrell dhe Lajçak, me Marrëveshjen e Brukselit/Ohrit, arritën që kompetencat e asociacionit t'i zgjerohet në nivel autonomie - 'vetëmenaxhimi' për serbët e Kosovës, si dhe i dorëzuan formalisht Qeverisë së Kosovës draft statutin e asociacionit, i cili: i referohet Rezolutës 1244, i zyrtarizon strukturat paralele në arsim e shëndetësi për disa vite, vendos arbitrazhin mbi Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës etj.

Për fatin e keq të Kosovës, mungesa e vetëdijes dhe përvojës shtetërore nga Qeveria e Kosovës, duke mos u dhënë hapësirë në këtë proces ekspertëve, duke mos

dëgjuar këshillat e aleatit kryesor, duke mos ofruar transparencë të procesit për opozitën për të marrë me kohë vërejtjet dhe sugjerimet, i dhanë të mbrapshtën dialogut.

Mbështetja nga aleatët për Kosovën nuk ka qenë asnjëherë më e ulët se tani. Kjo sigurisht nuk mundëson asnjë lloj marrëveshje të mirë për Kosovën në dialog apo në çfarëdo procesi euro-integrues. Si rezultat, dialogu është zhvendosur nga një proces "me njohjen në qendër" që mbështetej nga letrat e liderëve kryesorë perëndimorë, në një proces "me asociacionin në qendër e i orientuar në

menaxhimin e krizave".

Për fatin e keq të Kosovës, derisa në qeveritë paraprake integrimi i Kosovës ka qenë i përcaktuar nga reformat e Kosovës të parapara nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit e Qeverisë Mustafa, tani obligimet e Kosovës nga Marrëveshja e Brukselit/Ohrit janë vendosur si kritere në procesin e integrimit evropian të Kosovës.

Për fatin e keq të Kosovës, tani është krijuar një status quo e re në dialog. Qeveritë e ardhshme duhet të përballesh me pasojat, të kthejnë mbështetjen nga aleatët dhe të ri-nisin dialogun për njohje.

Kamberi dhe Lutfiu takojnë Lajçakun, diskutojnë për sfidat me të cilat ballafaqohen shqiptarët e Luginës

BRUKSEL, 5 PRILL - Kryetari i Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Luginë të Preshevës, Nevzad Lutfiu, ka njoftuar se bashkë me deputetin Shaip Kamberi kanë takuar në Bruksel emisararin e BE-së për dialogun Kosovë - Serbi dhe për çështje të tjera në Ballkanin Perëndimor, Miroslav Lajçak, për të bashkëbiseduar dhe për ta njoftuar me sfidat me të cilat ballafaqohen shqiptarët e Luginës. "E njoftuam z. Lajçak për hezitimin dhe mosgatishmërinë e shtetit për t'i integruar shqiptarët nëpër institucione shtetërore e për gatishmërinë që sistemi shtetëror e ka treguar për pasivizimin e shqiptarëve. Mosintegrimi i shqiptarëve në institucione i bënë institucionet jokredibile e diskriminuese, ndërsa aplikimi i pasivizimit tendencioz në vendet ku jetojnë

shqiptarët mundëson ndryshimin e strukturës etnike në ato vendbanime. Medvegja është shembulli më i mirë", ka shkruar Lutfiu në "Facebook".

Ai ka shkruar se Lajçakun e njoftuan edhe për rëndësinë dhe impaktin që për të diplomuarit nga Lugina do të kishte njohja e diplomave të Kosovës dhe se njohja e tyre do të nënkuptonte mundësi për një perspektivë të re për Luginën. "Mungesa e vullnetit politik për ta zhvilluar Luginën e Preshevës ekonomikisht, pasqyrohet më së miri me bojkotin total të shtetit në sjelljen e investitorëve në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë. Prandaj edhe komunat e banuara me shqiptarë janë ndër komunat më të pazhvilluara në vend. Infrastruktura e shkatërruar shkollore në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, përkaj moslejimit të



teksteve shkollore dhe mungesës së tyre në gjuhën shqipe, vështirëson edhe më shumë procesin edukativo-arsimor tek

nxënësit shqiptarë. E ardhmja evropiane duhet të jetë e vetmja rrugë për Ballkanin Perëndimor, ndërsa të drejtat e njeriut dhe

pakicave duhet të jenë parakusht esencial i vazhdimet të rrugës së mëtejme drejt Brukselimit Evropian", ka thënë Lutfiu.

Rreziku nga pickimi i rriqrave, IKShPK-ja del me disa rekomandime

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 PRILL - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka dalë me disa rekomandime për qytetarët, pasi me rritjen e temperaturave rritet edhe mundësia e pickimit nga rriqrat që janë bartëse të virusit që i shkakton Ethet Hemorragjike (EHKK).

IKShPK-ja ka njoftuar se është duke e përcjell në mënyrë permanente situatën epidemiologjike në vend lidhur me Ethet Hemorragjike Krime-Kongo (EHKK) dhe do ta vazhdojë mbikëqyrjen dhe hulumtimin epidemiologjik të gjitha vatrave dhe zonave endemike, karakteristike për këtë infeksion viral. "Duke qenë se me



ngritjen e temperaturave rritet mundësia e pickimit nga rriqrat që janë bartëse të virusit që i shkakton Ethet Hemorragjike, IKShPK-ja në bashkëpunim me institucionet e tjera të nivelit qendror dhe lokal do t'i ndërmarrë masat profilaktike

dhe kundërepidemike për të parandaluar epidemi të EHKK-së. Pavarësisht faktit se që nga viti 2013 nuk është shënuar asnjë rast fatal me EHKK pasi janë realizuar me sukses masat profilaktike dhe kundërepidemike, institucionet

e tre niveleve të kujdesit shëndetësor duhet të bëjnë me kohë përgatitjet meqë bëhet fjalë për një sëmundje endemike, por edhe vdekjeprurëse. Edhe pse rreziku nga ethet hemorragjike është më i vogël se vitet e kaluara, qytetarëve u bëhet thirrje që të kenë kujdes nga pickimet e rriqrave, sidomos në zonat Malishevë, Rahovec, Suharekë dhe Klinë, por edhe në zonat e tjera, pasi që temperaturat kanë filluar të ngrehen dhe rriqrat dalin në sipërfaqe të tokës", ka njoftuar IKShPK-ja.

IKShPK-ja u rekomandon qytetarëve të mos qëndrojnë pa nevojë në livadhe dhe vende me shkurre, por nëse patjetër duhet të jenë të pranishëm në këto vende, të vishen me rroba të gjata dhe pantallonat të futen në

çorapë, t'i lyejnë pjesët e trupit, sidomos pjesët e zbuluara si shuplakat dhe qafën me preparate të cilat i dëbojnë insektet nga trupi i njeriut, ta kontrollojnë trupin pas qëndrimit në vatra endemike si dhe pas kthimit nga punët në fusha/livadhe, ara apo vendet me shkurre, nëse u ngjitet ndonjë rriqër në trup, të shkojnë sa më parë në qendrën më të afërt mjekësore për heqjen e saj dhe marrjen e ndihmës shëndetësore, të kositet në vazhdimësi bari në oborre e livadhe, të bëhet dezinfektimi selektiv i hapësirave në vendet endemike (shkurret, kaçubat, djerrinat dhe livadhet e pakositura të lëna djerrë), të bëhet pastrimi dhe dezinfektimi i stallave në vazhdimësi dhe të mbahet higjiena personale në nivelin më të lartë.

LDK-ja: Rritja e çmimeve të produktet bazë gjatë tre viteve të fundit ka shkuar deri në 42 %

PRISHTINË, 5 PRILL - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) përmes një reagimi për medie ka theksuar se demanton deklaratat e pavërteta të qeverisë se e njëjta është kujdesur për mirëqenie të qytetarëve. "Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës çmimet në Kosovë që nga marrja e mandatit të kësaj qeverie, janë ngritur përplot 25%. Kjo ngritje enorme e çmimeve është me larta ndonjëherë në historinë e Kosovës. Pra, kjo qeveri me mosveprim ka ndikuar që jeta e qytetarëve të vështirësohet. Rritje e

çmimeve të produktet bazike gjatë tre viteve të fundit ka shkuar deri 42%, këto janë produkte që na duhen çdo ditë në tavolinë si: buka, mielli, vaji, kripa, sheqeri, qumështi e vezët. Krahas ngritjes enorme të çmimeve të produkteve bazike, qytetarit të Kosovës gjatë tre viteve të fundit me qeverisjen aktuale i është zbritur paga për një të katërtën në terma real", thuhet në reagimin e LDK-së. Sipas LDK-së, propagandë të pushtetit kemi edhe kur flitet për inflacion. "Por faktet tregojnë qartazi se Kosova ka inflacion

enorm. Inflacioni është faktori kryesor që ka ndikuar në rritje të buxhetit e në qarkullim të bizneseve, të cilat qeveria po i shet si sukses, por ky veç se sukses nuk mund të quhet. Deklaratat e fryra dhe të propaganduara të kësaj qeverie, bien në kundërshtim me realitetin që po jetojmë. Lidhja Demokratike e Kosovës propagandën e kësaj qeverie, e demaskon me publikimin e shifrave zyrtare. Shifra të cilat janë shqetësuese për mirëqenien e qytetarit", është theksuar në reagimin e LDK-së.



FMN-ja parasheh se rritja ekonomike në Kosovë do të jetë 3.8 për qind



PRISHTINË, 5 PRILL - Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), i udhëhequr nga Sebastian Sosa, ka vizituar Prishtinën gjatë periudhës 18-27 mars 2024, për diskutime mbi rishikimin e dytë të Marrëveshjes Stand-By (SBA) dhe Instrumentit të Reziliencës dhe Qëndrueshmërisë (RSF). Pas diskutimeve virtuale shtesë të misionit me autoritetet, Sosa ka lëshuar këtë deklaratë: "Ekipi i FMN-së dhe autoritetet e Kosovës arritën dakordim në nivel të stafit për përmbylljen e rishikimit të dytë të SBA-së dhe RSF marrëveshjeve. Zbatimi i

programit vazhdon të jetë në rrugën e duhur, me përmbushje të të gjitha caqeve kuantitative të fundit të dhjetorit 2023 dhe me avancim të kënaqshëm në agjendën e dakorduar të reformave strukturore. Pas aprovimit nga Bordi Ekzekutiv i FMN-së, i cili pritet të bëhet në gjysmën e dytë të muajit maj, përfundimi i rishikimit të dytë do të vë në dispozicion 13.35 milionë SDR shtesë (16.34 milionë euro) në kuadër të SBA-së dhe 7.74 milionë SDR (9.47 milionë euro) në kuadër të RSF-së", është thënë në deklaratë. Sipas kësaj deklarate, autoritetet

janë shprehur se synojnë ta vazhdojnë trajtimin e SBA-s si masë e kujdesit paraprak. "Ekonomia e Kosovës ka vazhduar të performojë mirë, përkundër mjedisit të jashtëm sfidues. Rritja reale e BPV-së u ngadalësua në 3.3 për qind në vitin 2023, pas zbutjes së rritjes ekonomike të partnerët kryesorë tregtarë dhe shtetë me prani më të madhe të diasporës. Inflacioni ka rënë ndjeshëm si pasojë e uljes së çmimeve të lëndës së parë, duke arritur në 2.2 për qind në krahasim me vitin paraprak në muajin shkurt", është thënë në deklaratën e FMN-së.

Auditorja e Përgjithshme, pjesë e konferencës së Bankës Botërore "Rishikimi i shpenzimeve si mjet për fuqizimin e qeverisjes lokale"

PRISHTINË, 5 PRILL - Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, mori pjesë në konferencën dyditore të Bankës Botërore "Rishikimi i shpenzimeve si mjet për fuqizimin e qeverisjes lokale në Ballkanin perëndimor", mbajtur më 3 dhe 4 prill në Vjenë të Austrisë dhe mbështetur nga Fondi i Mirëbesimit të Bashkimit Evropian për fuqizimin e qeverisjes fiskale në Ballkanin Perëndimor. Konferenca e mirëpritur solli në një vend zyrtarë të lartë të politikës fiskale, buxhetimit, përfaqësues të Bankës Botërore, Komisionit të Evropës, OECD,

institucioneve supreme të auditimit, ministrive të financave nga Ballkani Perëndimor, përfaqësues përkatës të shteteve të Bashkimit Evropian si dhe partnerë të tjerë që praktikojnë rishikimin e shpenzimeve si mjet. Qëllimi i aktivitetit që gjenerimi dhe shkëmbimi i përvojave me qasje praktike për dizajn, kryerje dhe zbatim të rezultateve të rishikimeve të shpenzimeve si dhe integrimi i tyre në proceset buxhetore. Konferenca u hap nga Xiaoqing Yu, drejtor i Bankës Botërore në vend dhe Uwe Stamm, kryesues i

njësisë DG EFCIN nga Komisioni Evropian. Zhvilluar në panele të ndryshme, kishte kontribute nga përfaqësues të lartë nga Ministria e Financave në Danimarkë, Autoriteti i Pavarur Fiskal i Spanjës, Ministria e Financave në Holandë, Ministria e Financave e Estonisë si dhe ajo e Sllovakisë. Paneli në përmbyllje trajtoi sfidat përkatëse të rishikimit të shpenzimeve në Ballkanin Perëndimor, ndërsa Republika e Kosovës që përfaqësuar nga Salvador Elmazi, drejtor i Departamentit të Buxhetit nga Ministria e Financave.



Nga 1 qershori qytetarët do të kompensohen për rrymën në veri

PRISHTINË, 5 PRILL - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRrE) ka mbajtur të premtën një mbledhje të jashtëzakonshme, duke bërë me dije se nga 1 qershori i këtij viti do t'i kompensojë qytetarët për rrymën e shpenzuar në veri në veri.

shpenzuar përfshin vitet 2012-2017. "Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në mbledhjen e katërt (IV) për këtë vit, të mbajtur sot, me datë 5 prill 2024, ka ndërmarrë veprimet ligjore për zbatim të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese që ka të bëjë me kompensimin e dëmit konsumatorëve, të cilët janë

faturuar për shpenzimet e energjisë elektrike në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës për periudhën kohore nga dt. 06.02.2012 e deri më dt. 20.10.2017. Bordi i ZRRE-së, sipas Aktgjykimit të Gjykatës, ka vendosur t'i obligojë Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike t'i kompensojë vetëm

konsumatorët të cilët vërtetohet se kanë qenë aktivë dhe kanë kryer detyrimet e pagesave për periudhën nga data 06.02.2012 deri më 20.10.2017. Këta konsumatorë do të kompensohen duke u zbritur në faturat e rregullta mujore vlerën përkatëse të kompensimit. Sipas vendimit të Bordit të ZRRE-së, kompensimi



i konsumatorëve do të bëhet duke filluar nga data 1 qershor 2024 deri më 28 shkurt 2030", ka njoftuar ZRRrE-ja.

DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (15)



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

-79-

Vetëm për përdorim zyrtar

Raport analize i FBIS
5 gusht 1981

Zhvendosja e ekuilibrit etnik të Kosovës: Kërcënim i mundshëm për stabilitetin e Jugosllavisë

Hyrje

Aftësia e Jugosllavisë për të ruajtur paqen në mes grupeve të saj të ndryshme etnike është ballafaquar me një test në Kosovë, njëra prej dy "krahinave autonome" në Republikën jugore të Serbisë. Anëtarë të komunitetit shqiptar në krahinë u hodhën në demonstrata në mars dhe prill, duke kërkuar shkëputjen e Kosovës nga Serbia dhe ngritjen e saj në statusin e Republikës. Autoritetet jugosllave hodhën poshtë menjëherë kërkesat e demonstruesve, shtypën trazirat dhe filluan spastrimin e nacionalistëve shqiptarë. Situata në këtë krahinë disa muaj më vonë ka mbetur shqetësuese, dhe nacionalizmi shqiptar vazhdon të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të veta sipas rastit.

Shkaku kryesor i tensionit më të fundit ka qenë epërsia gjithnjë në rritje e shumicës myslimane shqiptare në lidhje me pakicat sllave serbe dhe malazeze në këtë krahinë. Kjo mungesë e ekuilibrit etnik është acaruar në vitet e fundit nga shkalla e lartë e lindshmërisë së shqiptarëve dhe emigrimi i serbëve dhe malazezëve nga krahina – një lëvizje që u përshpejtua pas dëbimit në vitin 1966 të shefit serb të sigurisë, Aleksandër Ranković, i cili përfaqësonte vijën e ashpër të Titos. Emigrimi, një temë që prej vitesh ka qenë e ndaluar për diskutim publik në Jugosllavi, është ushqyer nga shqetësimet serbe se vazhdimi i zhvendosjes demografike në favor të shqiptarëve të Kosovës, do të dobësojë edhe më shumë qëndrimin e serbëve në rajon. Shqetësimet e Serbisë duket se janë nxitur nga Shqipëria fqinje, e cila mbështeste haptazi kërkesat e demonstruesve.

Këmbëngulja e Serbisë për të mbajtur Kosovën si Krahinë mund të bëhet e pabazë nëse vazhdon zhvendosja demografike. Vazhdimi i statusit të krahinës ka të ngjarë që të provokojë

pakënaqësi të reja dhe trazira në radhët e shqiptarëve të Kosovës. Megjithatë, humbja e Kosovës për Serbinë mund të ketë pasojë negative me ndikim të gjerë për ekuilibrin delikat etnik të Jugosllavisë. Ajo mund të nxisë serbët që të kërkojnë status më të lartë në Republika të tilla, si në Kroacia dhe Bosnje-Hercegovina, ku bashkëtojnë popullsi të mëdha serbe me grupe të tjera etnike, dhe përfundimisht mund të shkatërrojë politikën e tolerancës dhe barazisë etnike që e ka mbajtur Jugosllavinë të bashkuar deri më sot.

Ky raport shqyrton evoluimin e statusit aktual të çështjes demografike të pasqyruar në medien jugosllave. Diskutimi publik i kësaj çështjeje tregon se presioni nga serbët në vetë Serbinë dhe në Kosovë ka sjellë lëvizjet e para për të trajtuar çështjen e emigrimit, por se natyra e rënjosur thellë e problemit dhe hezitimi në radhët e zyrtarëve shqiptarë të Kosovës sjell perspektivën që, në rastin më të mirë, zgjidhja të jetë e pasigurt.

-80-

Vetëm për përdorim zyrtar

Raport analize i FBIS
5 gusht 1981

Zhvendosja e ekuilibrit etnik të Kosovës: Kërcënim i mundshëm për stabilitetin e Jugosllavisë

Rezultatet e Censurit të vitit 1981 nga rezultatet paraprake të censurit të vitit 1981, të publikuar në maj në medien jugosllave janë konfirmuar treguesit se balanca etnike e Krahinës së Kosovës është zhvendosur gjithnjë e më shumë në favor të shumicës shqiptare. Censusi tregon se popullsia etnike shqiptare në Kosovë është rritur më shumë se 300,000 që prej vitit 1971, duke shkuar nga 916,168 në 1,227,427. Ky fakt përfaqëson një normë vjetore të rritjes prej 3% - një nga më të lartat në Evropë - dhe një rritje të pjesës së shqiptarëve në popullsinë e krahinës nga 73.7% në 77.5%. Gjatë së njëjtës periudhë, numri i popullsisë etnike serbe ra më shumë se 18,000 nga 228,264 (18.4%) në 209,792 (13.2%). Popullsia malazeze e krahinës, etnikisht e ngjashme me atë serbe, ra gjithashtu, nga 31,555 (2.5%) në 26,875 (1.7%). Kështu, Kosova humbi më shumë se 23,000 serbë dhe malazezë (rënie prej 10%) gjatë dekadës së fundit për shkak të vdekjeve dhe emigrimit.

Ndërkohë që statistikët jugosllave të kombësisë kanë qenë shpesh të debatueshme dhe shifrat e censurit më të fundit nuk përbëjnë përjashtim - për shembull, gazeta e Tiranës "BASHKIMI" ka

parashikuar më 10 prill se shqiptarët mund të jenë paraqitur në numër më të vogël se ç'ishin në të vërtetë ndërsa e përditshmja e Shkupit "NOVA MAKEDONIJA" më 15 qershor tha se ata mund të jenë paraqitur në numër më të madh - të dhënat mbi vazhdimin e emigrimit të serbëve dhe malazezëve janë pranuar gjerësisht, veçanërisht në radhët e këtyre dy grupimeve. Gazeta e Kosovës në gjuhën serbo-kroate "JEDINSTVO", në një artikull të raportuar nga agjencia jugosllave e lajmeve "Tanjug", më 23 qershor, tha se popullsia serbe dhe malazeze e Bashkisë së Podujevës në verilindje të Kosovës ka rënë rreth tre të katërtat që prej vitit 1961, nga afërsisht 10,000 në 2,860. Po kështu, një raport i Radio Beogradit i datës 25 korrik citonte një zyrtar nga Kosova, i cili tha se kanë emigruar "fshatrat të tërë" me serbë dhe malazezë. Pretendime të tjera serbe dhe malazeze mbi shtrirjen e emigrimit kanë qenë edhe më gjithëpërfshirëse. Në një fjalim përpara Kuvendit jugosllav më 9 qershor, zyrtari malazez Batriq Jovanović citoi ekspertët serbë, të cilët pretendonin se Kosova kishte humbur rreth 40% të malazezëve dhe 20 deri në 30% të serbëve të saj gjatë 15 vjetëve që prej largimit të shefit të sigurisë Ranković. Shqetësimi i Republikës Serbe Zyrtarët serbë kanë shprehur shqetësimin e tyre në rritje mbi zhvendosjen e ekuilibrit etnik të krahinës. Kryeredaktori i Radio Beogradit, Milutin Milenković, theu heshtjen e gjatë publike të Jugosllavisë për çështjen e emigrimit në një koment në radio më 21 prill, ku shprehu shqetësimin për eksodin dhe bëri thirrje që të merren masa për të siguruar se të gjithë jugosllavët mund "të jetojnë dhe punojnë të patrazuar dhe në paqe në çdo pjesë të vendit". Që atëherë,

zyrtarë të lartë të Republikës serbe, së bashku me komentatorë të medias së Beogradit, i kanë bërë presion udhëheqjes së Kosovës për të frenuar presionet nacionaliste shqiptare që fajësohen për emigrimin. Komenti më i besueshëm serb për çështjen e emigrimit është bërë në një Plenum të Partisë serbe më 6 maj, i mbajtur një ditë pasi Plenumi i Kosovës kishte përjashtuar Kryetarin prej shumë kohësh të Partisë së krahinës dhe kishte transmetuar përhapjen e ndarjeve mbi nacionalizmin shqiptar. Udhëheqësi i Partisë serbe, Tihomir Vllaskaliq, duke folur për emigrimin e jo-shqiptarëve që prej trazirave, u bëri thirrje komunistëve etnikë shqiptarë në Kosovë që të tregonin "saktësi të plotë" për këtë çështje dhe të demonstrosnin "të njëjtën vendosmëri" kundër nacionalizmit shqiptar që Partia serbe kishte treguar në të kaluarën kundër nacionalizmit serb. Udhëheqësi i njohur serb, Dragoslav Marković, ishte më shumë polemizues, duke akuzuar se zyrtarët e Kosovës kishin "fshetur" çështjen e emigrimit dhe duke paralajmëruar se do të ishte "shumë e rrezikshme" nëse emigrimi do të vazhdonte. Sekretari i Partisë serbe, Spiro Galović, po ashtu paralajmëroi se vazhdimi i largimit të serbëve dhe malazezëve në fund të fundit do të ishte i dëmshëm për vetë interesat e shqiptarëve etnikë. Deklaratat vijuese publike të bëra nga zyrtarët serbë dhe komentuesit e medias kanë vazhduar presionin ndaj udhëheqjes së Kosovës. Në një mbledhje të Kuvendit serb më 11 qershor, një zyrtar akuzoi se sistemi penal i Kosovës diskriminonte jo-shqiptarët; një tjetër u ankua se fluksi i kohëve të fundit të serbëve në Serbi po shkaktonte përçarje dhe nxiste

nacionalizmin serb. Kryesia serbe kërkoi më 2 korrik që udhëheqja e Kosovës "të mprehte luftën dhe të forconte ligjshmërinë" në analizimin e shkaqeve të emigrimit, një detyrë që kërkonte "punën më të ndërgjegjshme të mundshme". Gazetat serbe i kanë shtuar benzinë zjarrit, duke raportuar dhunimin e varreve serbe në Kosovë dhe incidente të tjera anti-serbe dhe duke akuzuar Kosovën për diskriminim në shkallë të gjerë ndaj jo-shqiptarëve në politikën e punësimit, gjuhës, shitjen e pronës si dhe në fusha të tjera.

Reagim i ashpër për serbët dhe malazezët e Kosovës

Zyrtarë nga pakicat etnike serbe dhe malazeze të Kosovës, të inkurajuar haptazi nga mbështetja e fuqishme e Republikës serbe, kanë kërkuar gjithashtu që të merren masa për të parandaluar humbjen e mëtejshme të kushtetutave të tyre. Komenti i parë për këtë çështje doli më 5 maj në Plenumin e Kosovës, ku zyrtarët e partisë krahinore Mihajlo Zvicer dhe Lazar Vujović transmetuan ankesat e vjetra për statusin e jo-shqiptarëve të Kosovës. Duke nxitur një diskutim të hapur të të gjitha "temave tabu" të mëparshme, Zviceri, që është malazez, u ankua për politikën e kaluarës për emigrimin, gjuhën, punësimin dhe bëri thirrje për "vlerësim të plota, të sakta dhe gjithëpërfshirëse" të çështjes së emigrimit. Po kështu, Vujović kërkoi "ndalimin efektiv të shovinistëve që po i nxisin njerëzit" të largohen dhe paralajmëroi mbi nevojën për "parandalimin e këtij fenomeni që të mos marrë karakter masiv". Serbët e Kosovës Gjuro Trboviq dhe Bogolub Nedelković shprehën ankesa të ngjashme në një Plenum të Partisë jugosllave më 7 maj. Trboviq akuzoi nacionalistët shqiptarë për "dhunë



fizike”, dhe Nedeljković dënoi “ndjekjen” e jo-shqiptarëve.

Zyrtarë të tjerë serbë dhe malazezë të Kosovës përforcuan shqetësimet mbi emigrimin në javët e ardhshme. Në një Plenum të Partisë së Kosovës më 23 maj, një zyrtar nxiti “luftën kundër çdo përpjekjeje për presion dhe shantazh” që rezultoi në emigrim, dhe një tjetër ngriti zërin kundër diskriminimit në punë. Ndërkohë që disa zyrtarë serbë dhe malazezë e kanë trajtuar çështjen e emigrimit si një problem afatgjatë, Kryetari i Partisë krahinore Petar Kostiq bëri thirrje më 4 qershor për “ndërhyrje urgjente” për të ndaluar eksodin dhe kritikoi pikëpamjen se të drejtat e kombësisë duhet të jepen në përputhje me madhësinë e një grupi etnik. Gazeta e Kosovës “JEDINSTVO”, sipas “Tanjug” të datës 23 qershor, akuzoi se ekzistonte një “hendek” midis “asaj për të cilën është rënë dakord, dhe asaj që po bëhet” në lidhje me çështjen e emigrimit.

Zvarritja e shqiptarëve të Kosovës Udhëheqja shqiptare e Kosovës në pjesën më të madhe duket se e ka zvarritur çështjen e emigrimit, megjithë premtimet për të marrë masa korrigjuese. Pozita zyrtare e Partisë së Kosovës u shpjegua në një “program veprimi” të miratuar në Plenumin krahinor më 23 maj dhe doli në gazetën “BORBA” të Beogradit më 6 qershor. Ky artikull bënte thirrje që Partia të “vlerësojë dhe analizojë sa më shpejt shkaqet dhe fenomenet e emigrimit serb dhe malazez nga Kosova gjatë dekadës së fundit dhe të përcaktojë detyra specifike në këtë drejtim”. Kryetari i ri i Partisë së Kosovës, Veli Deva i cili u angazhua për këtë politikë më 4 qershor kur e quajti zgjidhjen e çështjes së emigrimit si një detyrë parësore politike, tha se Partia “nuk duhet të pajtohet me një rast të vetëm largimi”, dhe nxiti marrjen e masave “energji” për të krijuar “një atmosferë të tillë që do t’i japë fund këtij procesi”. Gjithsesi, shumë zyrtarë shqiptarë të Kosovës nuk kanë qenë aspak reagues ose të paafte ose jo të gatshëm që të trajtonin këtë problem në mënyrë vendimtare.

Njëra rrugë përmes së cilës zyrtarët shqiptarë të Kosovës duket se kanë penguar politikën partiake, ka qenë mosparaqitja e statistikave të emigrimit ose mungesa e ndihmës për të analizuar arsyet e emigrimit. Për shembull, anëtari i Kryesisë së Partisë së Kosovës, Sinan Sahiti, i qortoi më 27 maj autoritetet në qytetin e Ferizaj për mosrespektimin e kërkesës lidhur me të dhënat e emigrimit dhe la të kuptohet se moszbatimi është motivuar politikisht. Një tjetër shenjë e dukshme e rezistencës lokale erdhi kur një zyrtar i Mitrovicës tha hapur më 31 maj se “nuk ekziston asnjë presion për eksod të serbëve apo malazezëve” nga ajo krahinë dhe se çdo emigrim ishte shkaktuar nga faktorë të tjerë. Një mbledhje e Komisionit të Kosovës të formuar

së fundmi për çështjen e emigrimit, sipas “Tanjug” të datës 27 korrik, raportonte se shumë Bashki të Kosovës kishin regjistruar me qindra largime. Por, thuhet se disa e mohojnë ekzistencën e ndonjë presioni, dhe disa të tjerë nuk kishin arritur të bënin ndonjë gjë për të gjetur shkaqet e emigrimit.

Disa zyrtarë etnikë shqiptarë duket se po përdorin taktika më të mprehta për të penguar masat në çështjen e emigrimit. Në Plenumin e Kosovës më 23 maj, Kryetari i Partisë Deva raportoi një përpjekje të bërë nga disa zyrtarë të pidentifikuar për zbutjen e problemit, duke u përpjekur, por pa sukses, që të fusnin çështjen e emigrimit të shqiptarëve në programin e veprimit të Partisë. Udhëheqësi i organizatës së Lidhjes Socialiste të Kosovës, Azem Vllasi, duket se ka bërë disa përpjekje për t’ia hequr përgjegjësinë për këtë çështje komunistëve shqiptarë të krahinës. Sipas gazetës “BORBA” e Beogradit më 6 qershor, ai tha se i kishte kërkuar organeve republikane serbe për të kufizuar përkohësisht emigrimin dhe më 24 qershor ai tha në një mbledhje në Beograd se serbët dhe malazezët e Kosovës “nuk duhet të sillen si viktime pasive dhe vetëm të presin aksionin e komunistëve shqiptarë”. Mohimi nga ana e zyrtarëve shqiptarë të Kosovës se emigrimi është shkaktuar shpesh nga “presioni”, është përgënjeshtër më 7 qershor nga e përjavshmja e Beogradit “NIN”, e cila pohoi se presioni mund të marrë forma shumë të mprehta dhe të ndryshme në mungesë të kërcënimit apo dhunës së hapur. Mbështetja e Tiranës për demonstruesit

Shqipëria fqinje është përmbytur në çështjen demografike të Kosovës, mesa duket duke besuar se lëvizja etnike në fund të fundit shkon në favor të saj. Megjithatë, ajo ka zemëruar Jugosllavinë dhe ka nxitur më tej shqetësimet serbe me pikëpamjet e saj të shprehura për aspekte të tjera të situatës. Në një seri artikujsh që fillojnë me një kryeartikull të gazetës “ZËRI I POLULLIT”, Tirana mbështeti haptazi kërkesat “e drejta” të demonstruesve për statusin e Republikës brenda Jugosllavisë, dënoi rolin “brutal” të milicisë serbe në masat e ashpra, dhe akuzoi se shqiptarët e Kosovës janë shtypur politikisht dhe ekonomikisht. Ndërkohë që artikujt pretendonin se nuk kishte asnjë synim për ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë, ato ishin veçanërisht provokative në mbrojtje të së drejtës së Tiranës për të folur për “vëllezërit” e saj shqiptarë jashtë vendit, duke shkruar deri aty sa të pohonin në një kryeartikull të gazetës “Zëri i Popullit” të datës 17 maj se mosdhënia e statusit të Republikës për Kosovën do ta “kthejë këtë plagë në gangrenë”.



-81-

Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
EESD
FCO
5 gusht 1981
I nderuar Charles,

Kosova: pasqyrimi në media Përmbledhje

1. Kritikat e fundit nga një zyrtar Informacioni për Kosovën mbi disa pjesë të shtypit “të Beogradit” për trajtimin e trazirave në Kosovë, kanë nxitur reagime përçmuese nga gazetat e Beogradit, por tërhoqën mbështetje të paparashikuara publike nga disa anë të tjera shtypi tjetërkund në Jugosllavi. Një gjë e tillë ka shkaktuar ‘polemika’ të pahijshme midis publikimeve të ndryshme, ku ‘shtypi i Beogradit’ ka hedhur poshtë me forcë akuzat se pasqyrimi nga ana e tij është goditur nga senzacionalizmi apo nacionalizmi serb. Është shumë herët për të dalluar nëse kjo do të ndikojë në pasqyrimin e thekshëm kombëtar të Kosovës apo në tendencat e përgjithshme në drejtim të lirisë më të madhe të shtypit në Jugosllavi. Por kjo situatë demonstroi qartazi se sa lehtë mund të ndizen xhelozitë kombëtare në klimën e vështirë aktuale.

Detaje
2. Në letrat e mia për ju të datës 28 prill dhe 19 maj, kam përshkruar se si trazirat në Kosovë kanë çuar në një debat të gjallë mbi rolin e përgjithshëm të shtypit në Jugosllavi. Raportimi ynë për Kosovën që atëherë ka zbuluar (shpresoj) faktin që shtypi në tërësi, por në veçanti botime të tilla me bazë në Beograd si gazetat NIN, “Politika”, “Politika Ekspres” dhe “Duga”, i kanë ofruar publikut jugosllav që në prill një analizë të gjerë të problemeve të kaluara dhe aktuale në Kosovë. Disa nga zbulimet kanë vënë në siklet me të drejtë grupe të ndryshme të Kosovës dhe ndoshta kanë ndihmuar për të detyruar shumicën e dorëheqjeve të paraqitura nën presion deri tani. Ka pasur ankesa sporadike nga

Kosova se ky pasqyrim i fuqishëm i shtypit ka qenë jashtëzakonisht ‘senzacionalist’, pesimist ose edhe dëmtoes (shih, për shembull, letrat e mia për ju të datës 10 qershor, paragrafi 10, dhe të datës 17 qershor, paragrafi 3). Por debati në shtyp që ka pasuar vërejtjet e Mustafa Rushitit më 20 korrik, raportuar të nesërmen në gazetën “Politika”, ka pasur implikime më të gjera.

Fjalimi i Mustafa Rushitit

3. Duke hapur një mbledhje të Seksionit të Informacionit të Lidhjes Socialiste të Kosovës të mbledhur për të diskutuar temat dhe jo për të përgatitur një vlerësim përfundimtar, Kryetari i Seksionit, Mustafa Rushiti, kritikoi “gazetat e ndryshme të ilustruara” pasi kishin shkruar në “mënyrë të njëanshme, tendencioze dhe senzacionaliste”, duke mbjellë këshu mosbesim për forcat progresive dhe kombësinë shqiptare në Krahinë. Ndërkohë që gazetat “Oslobodjenje”, “Borba” dhe “Vjesnik” kishin qenë në përgjithësi konstruktive, gazeta “NIN” dhe revista të tjera (për shembull, “Duga” dhe “Ilustrovana Politika”) kishin paraqitur “kritika të përgjithshme dhe ofensive”. Në veçanti ai dënoi artikullin e Dr. Halit Trnavci në gazetën “NIN” (raportuar në letrën e Terence Clark për Alan Montgomery e datës 13 korrik), por gjithashtu pretendoi se edhe korrespondentët e “Tanjug-ut” në Prishtinë nganjëherë nuk kishin arritur të vlerësonin ndryshimet pozitive që po ndodhnin. Raportimi i fjalimit të tij nga gazeta “Politika” shprehte se këto komente çuan në një diskutim të gjatë, me mosmarrëveshje të shprehura për pika të ndryshme. Përgjigjet e ‘shtypit të Beogradit’

4. Siç mund ta imagjinojmë, publikimet e sulmuara nga Rushiti nuk ishin krejtësisht dakord me konkluzionet e tij. Gazeta “Politika” e datës 25 korrik iu shmang përgjigjes së drejtpërdrejtë duke ribotuar një artikull nga versioni serb i gazetës “Komunist” nga Mirko Arsiq. Arsiq tha se kritika e “disa tendencave negative” në Kosovë pasqyrore në fakt mbështetjen e plotë dhe pa rezervë nga pjesë të tjera në Jugosllavi për të gjitha ato forca në

Krahinë që trajtonin çështjen e kundërrevolucionit. Megjithatë, përpjekjet për t’i klasifikuar publikimet si të mira dhe të këqija mbi bazën e raportimit të tyre të përgjithshëm ishin të paprecedente, veçanërisht kur vetë shtypi i Kosovës nuk gjykohej në mënyrë të ngjashme. Ai pranoi se disa artikuj kishin qenë vërtetë të padobishme dhe senzacionaliste, por përgjithësimet e gjera në vend të kritikës së artikujve individualë ishin pavend. “Ky vlerësim i Kryetarit të Seksionit është shumë pranë papërgjegjshmërisë dhe favorizon nacionalizmin shqiptar”.

5. Gazeta “Borba” dhe “Politika” publikuan më pas më 27 korrik një përgjigje të dhënë nga “Tanjug”, e cila bëri komente të ngjashme dhe dënoi përpjekjet “për të ndezur një formë diferencimi brenda sistemit jugosllav të informacionit”. Përpjekje të tilla çuan në “një klasifikim të papranueshëm politik, i cili mund të përbante përpjekje të fshehta për të përhapur përçarje në shtypin jugosllav”. “Tanjug” shtoi se nëse disa nga korrespondentët e saj kishin pasur vështirësi të gjuhës në Kosovë, ky ishte pikërisht një problem që seksionet e informacionit në Krahinë duhet të kishin ndihmuar për ta zgjidhur.

6. Gazeta “NIN” publikoi komentet e saj më 31 korrik. Ajo tërhoqi vëmendje të veçantë në tre tema të artikullit të Dr. Trnavci, të cilat e kishin irrituar Rushitin: fakti që indoktrinimi i zgjatur nationalist në Krahinë ishte toleruar nga një rreth i ngushtë intelektualësh dhe politikanësh; nevoja për një vlerësim shumë më të vendosur të përgjegjësisë personale në nivelin e lartë politik në Kosovë; dhe shkalla e martesave dhe nepotizmit në radhët e qarqeve të larta. Çfarë konstatoi Rushiti “liberaliste” apo të pasaktë në gjithë këtë? Nuk ishte e lehtë të shkruhej për Kosovën, por ishte e nevojshme që të bëheshin hetime të thella të problemeve atje “jo për faktin se dikush duhet të marrë hak ndaj dikujt tjetër, por më tepër për të mbytur kundërrevolucionin akoma pa lindur”. Siç u shpreh gazeta “NIN”, duke ri-lexuar konkluzionet e qarta të organeve

më të larta politike në Jugosllavi, “është e vështirë të shmanget përshtypja se ndërkohë ka ndodhur diçka që ka bërë disa zyrtarë dhe medien informative t’i shohin detyrat që lindin nga këto konkluzione nga një këndvështrim tjetër...”.

Mbështetja për Rushitin

7. Sidoqoftë, më 29 korrik gazeta me qendër në Sarajevë “Oslobodjenje” publikoi një pjesë të Kemal Kurspashiq, të cilën gazeta “Politika” e ribotoi të nesërmen. Në fillim të muajit kishte pasur një luftë fjalësh midis redaktorit të gazetës “NIN” dhe asistent/kryeredaktorit të gazetës “Oslobodjenje”, i cili, së bashku me një redaktor të RTV Zagrebit kishte kritikuar pasqyrimin që gazeta “NIN” i kishte bërë çështjeve të ndryshme në Kosovë (veçanërisht emigrimit të serbëve dhe malazezëve); por Kurspashiq i vuri në një kontekst më të gjerë kritikën e Rushitit ndaj ‘Beogradit’. Ai kërkonte të dinte pse disa botime ishin të gatshme të kritikonin të tjerët në emër të lirisë së shtypit, por nga ana tjetër, “tregonin dhëmbët e tyre” ndaj njerëzve që i kritikonin ato. Ai tha se shumë pjesë nga fjalimi i Rushitit përmendnin realisht punën e medias në Kosovë por që komentuesit i kishin injoruar ato. Për më tepër, të njëjtët njerëz që kishin hedhur poshtë klasifikimet e përgjithshme të shtypit jugosllav po kërkonin që një procedurë e tillë të zhvillohej në Kosovë. Ndërkohë që të gjithë ishin bërë një në dënimin e kundërrevolucionit në Kosovë, “ne nuk mund të një mendjeje për rolin e informacionit në aksionin politik kur në të njëjtën kohë ekzistojnë artikuj dhe gazeta që janë më të angazhuara me regjistrimin e shpërthimeve nacionaliste sesa me përpjekjet pozitive për normalizimin e tyre”. Ekzistonte një implikim i dukshëm në fjalët e Kurspashiq se nacionalizmi serb ishte pas sulmeve të ‘shtypit të Beogradit’ ndaj Rushitit.

8. Duke që ishte shumë vonë që gazeta NIN të reagoonte, por gazeta “Politika Ekspres” e datës 29 korrik nuk u tërhoq nga kritikën e saj në trajtimin e atyre që kërkonin të sulmonin “mediet e tjera të popullit”. Artikulli citonte se shtypi në Serbi mbante përgjegjësi të veçantë për kanalizimin e Kosovës prej një dekade si Krahina që ishte përpjekur të shmangte rolin e saj si pjesë përbërëse e Serbisë, duke iu drejtuar drejtpërdrejt Federatës, duke bllokuar në këtë mënyrë përpjekjet e Serbisë për të ndjekur politika të përgjithshme në të gjithë Republikën në tërësi. Në luftën e informacionit brenda Serbisë ka pasur suksese dhe gabime, por tendenca më e fundit në drejtim të vëzhgimit të “medieve të tjera të popullit” ka qenë alarmuese. “Këto kritika mesa duket janë të lidhura nga një fije e padukshme, meqenëse pak a shumë të gjitha në mënyrë të



drejtpërdrejtë apo të tërthortë, synojnë të jenë në qendër të vëmendjes të të ashtuquajturit shtypi ‘serb’ ose ‘i Beogradit’, duke mbajtur të fshehur anën e errët të qëllimeve të tyre”. Natyrisht, nëse (siç ishte e nevojshme) shtypi në Serbi është përfshirë veçanërisht në problemet e Kosovës, logjikisht kishte më shumë të ngjarë që të bënte më shumë gabime; por ishte e rëndësishme që kritika praktikisht të njëjta për Serbinë të vinin nga Shqipëria, e cila kërkonte të tregonte se ‘problemi i Kosovës’ ishte krijim serb.

9. Kjo përmbledhje irrituese por inteligjente e debatit të Bozidar Bogdanoviq, asistent redaktor në gazetën “Politika Ekspres”, provokoi nga ana e tij shkrimin e një letre çuditërisht të paqartë të Milan Uzelac, Sekretar i Kryesisë së Aleancës Socialiste të Bosnje-Hercegovinës, ku Bogdanoviq akuzohej se kishte krijuar përçarje “në një mënyrë të ashpër dhe të papranueshme” dhe se kishte përdorur “logjikë të çuditshme” për të ndarë përgjegjësinë mbi ngjarjet në Kosovë midis së kaluarës dhe të tashmes. Gazeta “Politika Ekspres” publikoi më 4 gusht një letër “thjeshtë sepse Shoku Uzelac ka marrë përsipër të drejtën për të folur në emër të Kryesisë së Aleancës Socialiste të Bosnje-Hercegovinës. Ndryshe, shpjegimet dhe argumentet e tij nuk janë në një nivel të tillë që të lejojë zhvillimin e një dialogu me vlerë”.

Përpjekje për pajtim?

10. Pas shkëmbimeve të tilla të hidhura, gazeta “Politika” botoi më 2 gusht një artikull të Slavoljub Gjukiqit, ku përpjeqet të qetësonte gjërat. Ai tha se defektet në raportimin e Kosovës ishin lehtësisht të korrigjueshme, “por është shumë më e vështirë që të mbushen disa çarje, të cilat po krijohen në shoqërinë tonë dhe po përhapen në mënyrë alarmuese”. Ndarjet në shtyp që pranonin vlerat bazë të Jugosllavisë ishin të menaxhueshme, por “dashur pa dashur shtypi Republikan po transformohet në një forum të interesave krahinore. Një gjë e tillë ka një çmim të lartë dhe pasoja të dhimbshme politike”. Lexuesit e zakonshëm mund të mendojnë se mosmarrëveshjet midis shtypit në

Republika të ndryshme pasqyronin qëndrime të ndryshme të udhëheqësve të tyre politikë, “një gjë më se serioze”. Beteja kundër nacionalizmit “nuk fitohet me fjalë por me punë të përditshme të lodhshme në të cilën mbizotërojnë përgjegjësia dhe ndjenja e përbashkët”. Javët në vazhdim do të tregojnë nëse ky apel për bashkimka funksionuar. Pasoja e kësaj politike

11. Vetë Rushiti duket i padruajtur. Në një mbledhje të Konferencës së Lidhjes Socialiste të Kosovës më 31 korrik (raportuar më 1 gusht në gazetën “Borba”) ai kërkoi falje për faktin se gazetarëve nuk u ishin afruar lehtësirat e duhura të përkthimit në mbledhjen e mëparshme, por përsëriti kritikën e tij (këtë herë me shembuj që nuk i dha gazeta “Borba”) dhe tha se komentet e “Tanjugut” ishin “plot me insinuata”, ndërsa pjesa e Arsiqit “fliste vetë”. Kryetari i Lidhjes Socialiste Azem Vllasi tha se Sekretariati i Informacionit nuk duhej të përfshihej në argumentime nëse një artikull i dhënë ishte apo jo i dobishëm. Mendimet personale ishin jashtë temës në fjalë. Një mbledhje e Kryesisë do të kryente në kohën e duhur një vlerësim të plotë të çështjeve të informimit në lidhje me Kosovën.

12. Ndërkohë që pasqyrimi nga ana e shtypit është përgjithësisht më i dobët në korrik dhe gusht, realisht nuk është e mundur të dallohet nëse të gjitha këto argumente do të ndikojnë në analizën për Kosovën. Gazeta “NIN” duket se vazhdon si zakonisht, por një deklaratë pothuajse e pacipë e Fakultetit Filozofik në Universitetin e Prishtinës se “bashkëpunimi me Universitetet e huaja, veçanërisht me atë të Tiranës, ka qenë i suksesshëm, i denjë dhe shumë i dobishëm”, është raportuar drejtpërdrejt në gazetën “Politika” pa komentimin hokatar që ka shoqëruar deklaratën të tilla deri tani. Kjo deklaratë u raportua po ashtu me qetësi në TV, duke e lënë në dorë të audiencës që të nxjerrë konkluzionet e veta. Për më tepër, shtypi ‘i Beogradit’ ka përdorur padyshim ekspozimin e shprehjeve nacionaliste në Kosovë për të zmadhuar rolin e tij në

Jugosllavi. Në aspektin afatgjatë, mund të pritet që shprehjet e kritikizmit të mprehtë dhe kërkesës për analizë të përfutur në këtë zonë të zbatohen tjetërkund, kështu që do të ishte tejet pa vend nëse ky kundër-sulm nga Kosova do të çonte në një reduktim të gjithanshëm, të vetë-imponuar ose ndryshe, në gatishmërinë e shtypit për t’u vënë në krye të denoncimit të korrupsionit dhe paaftësisë.

Komente

13. Në këtë debat jam ndalur në detaje sepse në mënyrë të tërthortë ilustrojmë qartë disa nga problemet kryesore me të cilat Serbia (dhe Jugosllavia) po përballet në trajtimin e çështjes së Kosovës. Fakt kryesor është se për një dekadë e më shumë Kosova shfrytëzoi boshllëqet në marrëdhëniet kushtetuese të saj me Serbinë dhe fitoi një gjendje praktikisht të pavarur në të cilën grupi udhëheqës i bashkuar i Kosovës ishte në gjendje të kryesonte, praktikisht në mënyrë të padiskutueshme, një rritje të qëndrueshme dhe të fshehtë të ndjenjës nacionaliste shqiptare. Nëse duhet të shmangët një krizë e madhe kushtetuese në Jugosllavi, Serbia duhet të rifitojë njëfarë kontrolli të konsiderueshëm mbi Kosovën duke rishpallur kompetencat e saj dhe duke siguruar se udhëheqja lokale nuk do të dalë jashtë kontrollit. Padyshim, duke ndjekur një objektiv të tillë, Serbia do të bjerë në kundërshtim me vetë Kosovën nga interesat vetjake aty, por po fillon të shikojë sikur këto interesa do të merren me vete në ndryshime të rëndësishme të udhëheqjes që parashikohen të ndodhin sot dhe në të ardhmen. Gjithashtu, Serbia do të duhet të tregojë takt nëse kërkon të shmangë ngritjen e dyshimeve të Republikave të tjera të cilat kanë shqetësime historike për “nacionalizmin serb”. Argumenti më i mirë që ka Serbia, është në thelb i njëjtë me atë të përdorur nga Bozidar Bogdanoviq në artikullin e gazetës “Politika Ekspres” të cituar më lart: është në vetë natyrën e problemit të Kosovës që Serbia duhet të vihet në krye dhe të adoptojë linjën më të fortë në zgjidhjen e këtij

problemi. Është shqetësues fakti se burime të caktuara të rëndësishme të shtypit në Republika të tjera mesa duket, nuk janë të sigurta.

14. Kopje të kësaj shkrese do t’ua dërgoj javën tjetër për departamentet e tjera të FCO.

I Juaji

Charles Crawford

Oficer Informacioni

-82-

Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq

Ambasada britanike

EESD

Beograd

FCO

5 gusht 1981

I nderuar Charles,

Kosova: proceset gjyqësore

1. Siç ka raportuar tashmë edhe BBC, gjatë javës së fundit janë zhvilluar proceset gjyqësore të disa prej demonstruesve të marsit dhe prillit. Dënimet kanë qenë të ashpra, pa dyshim për të shërbyer si efekt parandalues për ata që do të guxonin të dilnin në demonstrata.

2. Gazeta “Borba” e datës 30 korrik përmbante një raport (bashkëngjitur përkthimi) të procesit gjyqësor të pesë personave të zhvilluar në Mitrovicë, me akuzën se kishin organizuar dhe marrë pjesë në d e m o n s t r a t a t “kundërrevolucionare”. Është me interes të thuhet se vetëm dy nga të akuzuarit ishin studentë. Dënimet e tyre silleshin nga 6½ vjet në 8½ vjet.

3. Megjithatë, gjyqi kryesor u zhvillua javën e kaluar në Prishtinë, dhe gazeta “Borba” raportoi më 3 gusht se njëmbëdhjetë persona ishin nën gjykim për aktivitete armiqësore. Dhjetë prej tyre u dënuan me 7 dhe 13 vjet dhe i njëmbëdhjetë u dënua me një vit burgim. Krimi i tyre më i rëndësishëm ishte se kishin vjedhur një automjet në një karvan automjetesh zyrtarë të Sekretariatit Federal të Punëve të Brendshme (SSUP) në një fshat të quajtur Besi, që është rreth 8 milje larg Prishtinës. Ata plaçkitën kamionin me armë dhe municion dhe armët u ndanë në radhët e grupit dhe u fshehën në vende të ndryshme. Grupi u kap shpejt nga oficerët e SSUP, të cilët i rimorën armët. Anëtarët i trembëdhjetë i grupit, i cili nuk kishte marrë pjesë në këtë sulm, dorëzoi një pushkë dhe 70 fishekë në zyrën e pushtetit lokal që ia kishte dhënë njëri prej sulmuesve, dhe u akuzua se kishte fshehur një armë të vjedhur.

4. Megjithatë dënimet janë jashtëzakonisht të rënda sipas standardeve jugosllave, ndoshta është e drejtë të thuhet se personat që vjedhin armë nga forcat britanike do të merrnin mbasë të njëjtin dënim, me pëlqimin e Madhërisë së Saj.

I Juaji

J. Ward

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Sot dy ndeshje, nesër derbi Llapi - Drita



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 PRILL - Superliga e Kosovës në futboll vazhdon të bëhet gjithnjë e më interesante derisa në javën e fundit ka pasur ndryshim edhe në renditjen tabelore ku Llapi ka marrë kryesimin dhe Ballkani tash zë vendin e dytë. Gjilani - Fushë-Kosova është derbi që zhvillohet sot (e shtunë) nga ora 15:00. Gjilanasit me tri pikë të reja do të arrinin kuotën e 30 pikëve dhe do të ishin më të qetë, derisa "Pampurat" e Fushë-Kosovës e kanë këtë ndeshje për "jetë a vdekje", pasi me humbje thuajse do t'i shuanin shpresat përfundimisht për mbetje në elitë. Ndeshja tjetër është ajo në mes të Malishevës dhe Dukagjinit, e cila zhvillohet në stadiumin "Liman Gegaj". Malishevasit janë në formë

të jashtëzakonshme dhe presin edhe tri pikë të reja nga kjo përballje. Derisa klinasit do të mundohen të mos kthehen duarthatë nga kjo ndeshje mjaft e rëndësishme.

Të dielën zhvillohet derbi i dy skuadrave që po luftojnë për titull, Llapit dhe Dritës. Llapjanët do të mundohen ta ruajnë pozitën e liderit të Superligës edhe pas kësaj përballje në të njëjtën kohë të largojnë nga lufta për titull edhe më shumë Dritën, derisa gjilanasit synim e kanë të mposhtin skuadrën lidere dhe të barazohen me pikë. Punë më të lehtë në këtë xhiro ka Ballkani që përballet me Lirinë. Kampionët presin tri pikë, në anën tjetër presin gabimin eventual të Llapit për ta marrë kryesimin sërish. Ndeshja e fundit është mes Feronikelit 74 dhe Prishtinës.

SUPERLIGA - Java e 28-të

Të shtunën takohen:
15:00 Gjilani - Fushë Kosova
15:00 Malisheva - Dukagjini

Të dielën takohen:
15:00 Llapi - Drita
15:00 Feronikeli 74 - Prishtina
15:00 Ballkani - Liria

	Tabela	Pikë
1. Llapi	27	54
2. Ballkani	27	53
3. Drita	27	51
4. Malisheva	27	48
5. Prishtina	27	39
6. Dukagjini	27	35
7. Feronikeli 74	27	29
8. Gjilani	27	27
9. Fushë Kosova	27	20
10. Liria	27	10

SHKURT

Tifozët serbë provokojnë në Berlin me banerin 'Kosova është Serbi'

Tifozët serbë provokuan me parulla nacionaliste në drejtim të Kosovës, në Kupën e Botës në Katar. Parulla nacionaliste janë shfaqur sërish. Tifozët ultras serbë kanë shpalosur thirrje kundër Kosovës në një ndeshje të basketbollit. Më saktë, në ndeshjen e Partizanit kundër Alba Berlin, që u zhvillua në Berlin të Gjermanisë, tifozët serbë kanë shpalosur parullën "Kosova është serbi". Ndeshja është në kuadër të xhiros së 33-të të Euroligës.

Junior 06 triumfon në Ligën e Parë dhe siguron Superligën

Junior 06 Monia Bau ka triumfuar në finalen e dytë të "play-off" -it ndaj AA Prishtinës me rezultat 54:81. Çmimi MVP i takoi lojtares Yllza Uka. Medaljet, çmimin MVP dhe Kupën i dorëzoi Komisari i Garave, Faton Kurshumlja. Junior 06 fitoi 2:0 në seri kështu duke u shpallur kampion i Ligës së Parë Femrat, ndërsa në edicionin e radhës 2024/25 do të garojë në Superliga Femrat.

Vdes futbollisti 21-vjeçar nga Shqipëria, ra nga tarraca

Ka ndërruar jetë në Spitalin e Traumës 21-vjeçari lezhjan i cili ra aksidentalisht nga tarraca e biznesit të familjes në fshatin Torovicë. Lajmi i trishtë vjen nga Spitali i Traumës, ku bëhet me dije se Klajvert Çuni, i cili ndodhej i shtruar prej 23 marsit. Pavarësisht prej përkujdesjes së bluzave të bardha, i riu i cili ishte futbollist i akademisë së Shënkollit, nuk mundi t'u mbijetojë plagëve të marra në kokë e pjesë të tjera të trupit.

Lajm fantastik për tifozët e Malishevës, biletat pa pagesë

Nga tani e deri në fund të sezonit tifozët e klubit të futbollit Malisheva mund t'i përcjellin ndeshjet e Superligës pa paguar biletë. Ky është lajmi që klubi e ka dhënë sot duke i gëzuar tifozët. "Dy mbështetësit e zellshëm të klubit tonë, Afrim Bytyqi dhe Kastriot Krasniqi, mbulojnë shpenzimet e biletave për të gjithë tifozët deri në përfundim të këtij sezoni", thuhet në njoftimin e Malishevës.

Më 6 prill Malisheva do të përballet me Dukagjinin nga ora 15:00.

Malisheva po kalon një sezon tejet pozitiv sa i përket rezultateve dhe po synon daljen në garat evropiane për sezonin e ardhshëm.

'Dardanet' U19 mposhtin edhe Luksemburgun

Prishtinë, 5 prill - Përfaqësuesja e Kosovës U19 për vajza e ka mposhtur Luksemburgun me rezultat bindës 4-0 në kuadër të rrethit të dytë për kualifikimet e Evropianit 2024. "Dardanet" e reja me plot përkushtim iu qasën lojës që nga fillimi i ndeshjes. Në pjesën e parë

Kosova zbllokoi rezultatin duke shënuar golin e parë përmes Rreze Gashit në minutën e 40. Me të filluar pjesa e dytë, gjegjësisht në minutën e 49, Sahare Berisha shënoi për 2-0. Vetëm pesë minuta më pas, Alba Shabani thelloi epërsinë duke çuar

rezultatit e Kosovës në 3-0. Ekipi kundërshtar i cili nuk arriti t'i rezistojë Kosovës, pak para fundit zyrtar të ndeshjes, përkatësisht në minutën 82, shkaktoi autogol, çfarë bëri që Kosova ta përmbyllë takimin me Luksemburgun me shifrat 4-0.



Alonzo Verge Jr, MVP i xhiros së fundit në Superligë

PRISHTINË, 5 PRILL - Të enjten përfundoi zyrtarisht edicioni i rregullt në Prince Caffè Superligë. Dueli i fundit ishte ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Trepçës, ku therandasi ia ndërpreu serinë prej 20 fitoreve të mitrovicasve. Më i dalluari ishte

Alonzo Verge Jr me 25 pikë, shtatë kërcime dhe dy asistime. Verge Jr është ndër lojtarët kryesorë të Yllit në këtë edicion dhe nga lojtarët më të mirë të huaj në elitë. Istogu u përshëndet me humbje nga elita, por ndeshjen ndaj Proton Cable

Prizrenit nuk do ta harrojë Arian Azemi, i cili theu rekordin personal me 41 pikë, nëntë kërcime dhe shtatë asistime. Sigal Prishtina pësoi nga Vëllaznimi, derisa për bardhekaltrit nuk ndihmuan 34 pikët e 14 kërcimet nga Diamond Stone, derisa te

kuqezinjtë më i miri ishte Jahenns Manigat me 14 pikë, tetë kërcime dhe katër asistime. Peja mundi Bashkimin për të përfunduar në vendin e dytë, ku më i miri të kampionët e Kosovës ishte Jimmy Hall me 19 pikë, pesë kërcime dhe katër asistime.



Batatina: Slavia Pragë ka shprehur interesim për tre futbollistë të Llapit

PODUJEVË, 5 PRILL - Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, ka bërë me dije se Slavia Praga ka shprehur interesim për tre futbollistë të Llapit. Kryetrajneri i skuadrës nga Podujeva ka thënë se është takuar me Jiri Bilek, drejtor Sportiv i Slavia Pragë, Milan Martinoviç, menaxher ndërkombëtar kroat si dhe Agim Saraçi, menaxher shqiptar në Çeki. Batatina ka konfirmuar se në këtë takim është vendosur për një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet këtyre dy klubeve. "Kisha kënaqësinë që të takohem me Jiri Bilek, drejtor Sportiv i Slavia Pragë, Milan Martinoviç, menaxher ndërkombëtar kroat si dhe Agim Saraçi, menaxher shqiptar në Çeki ku dakorduam për bashkëpunimin mes dy klubeve, Llapi dhe Slavia Pragë. Kisha nderin që një klub i madh i Evropës ka besimin e plotë për të bashkëpunuar me Llapin si dhe së shpejti do të jem i ftuar në klubin e madh, Slavia Pragë për të diskutuar detaje edhe më të rëndësishme", ka shkruar



Batatina, i cili ka konfirmuar se skuadra çeke ka shprehur interesim për tre futbollistë të Llapit, por duke mos dhënë më shumë detaje se për cilët futbollistë bëhet fjalë. "Një lajm

shumë i madh për talentet kosovarë, e sidomos për futbollistët e Llapit, pasi që për tre futbollistë veç se kanë shprehur interesim për t'i filluar bisedimet zyrtare", ka nënvizuar Batatina.

Denveri i pafuqishëm ndaj Clippersave, triumfon Golden State

LOS ANXHELOS, 5 PRILL - Kampionët e Denverit u mundën me rezultat 102-100 nga Clippersat, duke pësuar humbjen e katërt në 10 takimet e fundit. Ndeshje me rivalitet deri në fund, ku për kampionët nuk mjaftoi "triple double" i Nikola Jokiq (36 pikë, 17 rebound, 10 asistime). Për Clippersat u dallua Paul George me 28 pikë. Jashtë fushe fiton ekipi i Golden State, që mundi me rezultat 133-110 Houstonit. Klay Thompson dhe Stephen Curry realizuan nga 29 pikë secili, duke rikthyer dyshen e famshme "splash brothers". Pa probleme fiton skuadra e Dallasis, që falë 51 pikëve



të dyshes Irving-Donqiq mundi me shifrat 109-95 Atlanta. Zhgënjën Miami, që humbet në fushën e tij

me rezultat 109-105 ndaj Philadelphias, sfidë ku u dallua Maxe me 37 pikë e 11 rebound.

REZULTATET

Dallas - Atlanta	109-95
Miami - Philadelphia	105-109
New York - Sacramento	120-109
Houston - Golden State	110-133
Clippers - Denver	102-100

SHKURT

Rrudhani shkëlqen me dy gola në Zvicër

Lausanne ka barazuar 3-3 në shtëpi ndaj St. Gallenit në kuadër të javës së 30 në Superligën e Zvicrës. E në këtë takim shkëlqeu futbollisti kosovar Donat Rrudhani. Rrudhani shënoi dy gola në këtë ballafaqim për Lausannen. Fillimisht ai barazoi shifrat 2-2 në minutën e 78, ndërsa barazoi edhe njëherë tjetër në 3-3 në minutën e 86 të takimit.

Sainz: Më duan të gjitha skuadrat e Formulës 1, por s'kam vendosur

Spanjoll Carlos Sainz është padyshim më i kërkuari në merkaton e pilotëve, teksa këtë verë të gjitha makinat kryesore do të synojnë të marrin 29-vjeçarin. Ai do të lërë Ferrari në fund të sezonit për t'i lënë vendin Lewis Hamiltonit. Kjo situatë nuk e tremb aspak pilotin spanjoll, pasi i di aftësitë e tij, siç e konfirmoi gara e fundit e Formulës 1 në Australi fituar prej tij. Nga Suzuka, ku të dielën zhvillohet gara e Japonisë, Sainz pranon se ka mjaft kërkesa dhe se po bisedon thuajse me të gjithë. "Po flasim praktikisht me të gjitha skuadrat. Ne po bisedojmë për t'u thelluar edhe më shumë në detaje, për të parë se cila mundësi është më reale. Cila do të jetë mundësia ime më e mirë për të ardhmen", ka thënë Carlos Sainz. "Nuk kam asgjë për t'u nxituar, por e di që duhet të vendos sa më shpejt të jetë e mundur, pasi edhe koha në dispozicion po mbaron. Shpresoj që për të ardhmen time të vendos para se të nisë vera", u shpreh piloti spanjoll i "kokëkuqes".

E ardhmja e Zidanes varet nga 'Euro 2024'

Zinedine Zidane është gati të kthehet në detyrë për një përvojë të re. I përmendur shpesh për një kalim te Bayern Muncheni, trajneri francez duket se ka ide të qarta në lidhje me atë që do të bëjë. Siç ka bërë me dije "El Mundo Deportivo", opsioni që tandon më shumë Zidanen është ai që do ta çonte te stoli i kombëtares franceze. Pasi ka refuzuar ofertat e ndryshme që ka marrë në javët e kaluara, "Zizou" do të donte ta kurorëzonte ëndrrën për ta drejtuar stolin e "Gjelave", duke marrë vendin e Deschampsit. Në lidhje me këtë, ecuria e Francës në "Euro 2024" mund të rezultojë vendimtare. Zidane, në fakt, po vlerëson me kujdes situatën e Deschampsit, i cili është blinduar nga federata me një kontratë deri në 2026-n.

Klopp: Nuk ishim në nivelin e duhur

Liverpooli e mposhti në "Anfield Road" Sheffield Unitedin (3-1). Pavarësisht prej fitores, Jurgen Klopp nuk është i kënaqur me lojën e djemve, teksa u shpreh se deri në momentin e zëvendësimeve skuadra e tij nuk u tregua në formën e saj më të mirë, ku rrezikoi jo pak, me rezultatin që shkoi 1-1, në fraksionin e dytë të lojës. "Loja jonë e përgjithshme derisa bëme ndryshimet nuk ishte e mrekullueshme. Kjo është ajo që duhet ta pranojmë. Është e ndërlukuar, ata nuk u mbrojtën shumë, por skuadra ime duhet të kishte bërë më mirë. Gjithsesi jam i kënaqur që me ndryshimet e bëra reagues", ka thënë Klopp.

PSG-ja e dëshiron Osimhenin në vend të Mbappes

Në skuadrën e PSG-së kanë filluar të mendojnë për pasardhësin e Kylian Mbappes, i cili, me gjasë, do të largohet në verë. Victor

Osimhen shihet si profili ideal, për këtë arsye e kanë vendosur në majën e listës së dëshirave. Pengesa e vetme në këtë pikë është

shuma që kërkon De Laurentiis, 130 milionë euro. Bosi i Napolit është i hapur të negociojë me çdo skuadër që kërkon shërbimet e

nigerianit, por as që ka ndër mend të bëjë lëshim kur bëhet fjalë për zbritjen e çmimit. Osimheni ka shumë oferta, mbi të gjitha nga

klube në Premierë Ligë, ku Chelsea, Arsenali dhe Manchester Unitedi janë të gatshëm të paguajnë një shifër të tillë.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "E.D BERISHA" SHPK, Malishevë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e gurit gëlqeror si gurë dekorativ në Zatriq, komuna e Rahovecit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.05.2024 në ora 11:00 në SHFMU "Dëshmorët e Zatriqit" Fshati Zatriq, Komuna Rahovec, do të organizohet debat publik nga Kompania "E.D BERISHA" SHPK, Malishevë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për shfrytëzimin e gurit gëlqeror si gurë dekorativ në Zatriq, komuna e Rahovecit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "E.D BERISHA" SHPK, Malishevë, për shfrytëzimin e gurit gëlqeror si gurë dekorativ në Zatriq, komuna e Rahovecit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Solin Ks" L.L.C Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore "Ramjan" me fuqi 65 MW në Ramjan, Viti.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.05.2024 në ora 11:30 në objektin e shtëpisë së kulturës "Grusel & Bajram Sulejmani" në sallën e Kuvendit Komunal të Vitisë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Solin Ks" L.L.C Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/81104488109?pwd=2FcrkaNsBbnvX0XUzu5MQfem31IN.1>

Meeting ID: 811 0448 8109

Passcode: 6Duf8Q

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Solin Ks" L.L.C Prishtinë për parkun e energjisë diellore "Ramjan" me fuqi 65 MW në Ramjan, Viti.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Vitia Solar" Sh.p.k Sofali, Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore "Sllatina" me fuqi 35 MW në Sllatinë, Viti.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.05.2024 në ora 11:00 në objektin e shtëpisë së kulturës "Grusel & Bajram Sulejmani" në sallën e Kuvendit Komunal të Vitisë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Vitia Solar" Sh.p.k Sofali, Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/81104488109?pwd=2FcrkaNsBbnvX0XUzu5MQfem31IN.1>

Meeting ID: 811 0448 8109

Passcode: 6Duf8Q

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Vitia Solar" Sh.p.k Sofali, Prishtinë për parkun e energjisë diellore "Sllatina" me fuqi 35 MW në Sllatinë, Viti.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Atdhe Deva nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Leonard Nrecaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Gresa Grajqevci shpall të pavlefshme ID-Kartelën e Kolegjit AAB Prishtinë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

